



2014

RAPORT VJETOR



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hr-jugor.com

Përmbajtja


Zonat e përgjegjësish të K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“		4
I.	RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	6
II.	RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV	14
2.1	Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit	14
2.1.1	Aktivitetet nga Shërbimi Teknik	14
2.1.2	Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	17
2.1.3	Planifikimi I investimeve emergjente	20
2.1.4	Furnizimi me ujë të pijes në Njësitë Punuese	20
2.1.5	Prodhimi I ujit - m3	21
2.1.6	Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	22
2.1.7	Servisimi I ujëmatësave	22
2.1.8	Zyra për planifikim dhe zhvillim	23
2.1.9	Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	25
2.2.1	Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	29
2.2.2	Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes	32
2.2.3	Raport I ankesave	32
2.2.4	Raport I mediave	32
2.3.1	Aktivitetet e Departamentit Administrativ	33
2.3.2	Personeli	37
2.3.3	Numri I punëtorëve sipas nacionaliteteve	38
2.3.4	Kualifikimi i punëtorëve	38
2.3.5	Procedimi I lëndëve në Gjykata për Kundërvajtje	39
2.3.6	Aktivitete të zyrës së teknologjisë Informative	50
2.3.7	Raport i zyrtarit per siguri dhe shendet ne punë	52
2.4.1	Aktivitetet nga Shërbimi financiar	52
2.4.1.1	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Prizren	56
2.4.1.2	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Suharekë	57
2.4.1.3	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Dragash	58
2.4.1.4	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Malishevë	59
2.4.1.5	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Hidroregjioni Jugor	60
2.4.1.6	Progresi me Planin e Biznesit	61
2.5	Pasqyrat Financiare	65
3	Investimet	73
3.1	Plani I investimeve Kapitale	73

3.1.1	Investimet - Ujësjetllës	74
3.1.2	Investimet- Kanalizim	75
3.1.3	Investimet nga donatoret dhe nga KRU „HJ” - 2014	76
IV	RAPORTI I AUDITORIT	85
4.1	Raport I auditorit të brendshëm	85
V	RAPORT NGA SHËRBIMI I PROKURIMIT	86
VI	PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM	90
6.1	Qellimet dhe objektivat strategjike per vitin 2014	90
6.2	Objektivat kryesore të KRU „Hidroregjioni Jugor”	90
6.3	Treguesit kryesor te performances 2013-2017	91
VII.	RREZIQET E TË ARDHMES	91
VIII	ORGANOGRAMI	92

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU "HIDROREGJIONI-JUGOR" sh.a Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësllësit



LEGJENDA:	
4	Zona e shërbimit
5	Qytetet me ujë
48	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga KRU
9	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga KRU + bashki
57	Fshatrat që nuk menaxhohen nga KRU-funksionale
18	Fshatrat që nuk menaxhohen nga KRU-afunksionale
52	Vendbanimet pa shërbime të ujësllësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

BORDI I DREJTORËVE

Dr. Naser Bajraktari

Kryesues i Bordit

Mob.: 044 113 373

045 761 761

e-mail: naser.bajraktari@ks-gov.net

Ing. I Dip. Galip Hoda

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 127 779

e-mail: galiphoda@hotmail.com

Ecc.i Dip. Bujar Hasani

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 217 239

e-mail: hasanibujar@hotmail.com

Arkitekthe e Dip. Drita Grazhda

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 191 214

e-mail: atelieprizreni@hotmail.com

Biolog i Dip. Sait Uka

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 140 026

e-mail: sahitukaj@hotmail.com

Fizikant i Dip. Besim Baraliu

Anëtar i Bordit

(Kryeshef Ekzekutiv)

Tel.&Fax.: 029 244 150

Mob.: 044 172 842

e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

I. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

KUR Hidroregjioni Jugor udhëhiqet nga Bordi i drejtorëve të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Bordi aktualisht përbëhet nga 5 drejtorë sepse 1 prej tyre ka dhënë dorëheqje (2010) dhe ende nuk është emëruar anëtari i 6 i bordit. Sipas kërkesës së KUR Hidroregjioni Jugor, NJPMNJ ka dhënë pëlqimin që bordi të vazhdojë punën me 5 anëtarë deri në riemërimin e ardhshëm. Komisioni i auditimit përbëhet nga 2 anëtarë në mungesë të anëtarit i cili ka dhënë dorëheqje.

Gjatë vitit 2014 bordi ka mbajtur 10 takime të rregullta mujore, sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me keto data: 24.01.2014; 14.03.2014; 29.04.2014; 19.06.2014; 26.06.2014; 15.07.2014; 04.08.2014; 20.08.2014; 16.10.2014; 31.10.2014.

Në këto takime angazhimet e bordit kanë të bëjnë me:

- Miratimin e raportit vjetor për vitin 2013
- Aprobimi i Plan-Biznesit për vitin 2015-2017
- Raportet e Zyrtarit të auditimit të brendshëm
- Është mbajtur Mbledhja së Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A (për vitin 2013)
- Bordi i Drejtorëve ka bërë vlerësimin e kryertjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë për vitin 2013: Kryeshefin Ekzekutiv, Zv. Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar, Sekretarin e Kompanisë, dhe Auditorin e Brendshëm. Me komentimin në performancën së përgjithshme të kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë janë pajtuar njëzëri të gjithë anëtarët e Bordit .
- Bazuar në nenin 20 dhe 22 të ligjit Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike dhe Neni 12 të ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Politikës së Kompensimit për Stafin Menaxhues , respektivisht Politikës mbi Kompensimin për stimulimin e efektshmerisë në bazë të performancës për Bordin e Drejtorëve dhe Zyrtarët e KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, me propozim të Komisionit të Auditimit, Bordit të Drejtorëve ka **Aprovuar DEKLARATËN PËR POLITIKËN E KOMPENSIMIT PËR DREJTORËT E BORDIT DHE ZYRTARËT E KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.** për vitin 2013.
- Bordi i drejtorëve të KRU „Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren në mbledhjen e mbajtur më 20.08.2014, ka analizuar të dhënat operative dhe financiare dhe ato të investimeve kapitale për riparime dhe mirëmbajtje si dhe ato të investimeve të reja për zgjerimin të bazës së asetëve dhe ngritjen e vlerës së saj. Këto të dhëna konsiderohen të arsyeshme dhe si të tilla i ka aprovuar dhe me këtë ka autorizuar Menaxhmentin e Kompanisë të aplikojë në ZRRUK për rishqyrtim të rregullt të tarifave ekzistuese për periudhën e ardhshme tri (3) vjeçare 2015-2017. Bordi ka qenë në dijeni edhe me të dhënat e pasqyruara në Modelin Softëerik (BPRR dhe MT) dhe tarifën e gjeneruar nga to, të cilat i konsiderojmë tarifa të planifikuara, sikur që jemi në dijeni edhe për mënyrën e financimit të shpenzimeve operative, ato të investimeve kapitale (me financim vetanak dhe ato të dhuruara) sikur se edhe për afatet kohore të fillimit dhe përfundimit të projekteve të tilla të cilat do të aprovohen. Pra në bazë të dhënave të tilla Bordi ka **autorizuar** Menaxhmentin Ekzekutiv i KRU „Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren të procedojë dhe udhëheq realizimin e këtij procesi gjerë në përfundim të tij.
- Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren, (me shtesë të përfshirjes edhe të Zyrtarëve të Kompanisë), mbështetur në propozimin e Komisionit të Auditimit, mbështetur në Ligjin Nr.04/L-111 nenit 12 pika iii Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet

Publike,dhe në Deklaratën për politiken e kompenzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU”Hidroregjionit Jugor ,në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2014 me VENDIM **aprovoj-miratoj** propozimin e Komisionit të Auditimit, të kompenzimit-bonusit te drejtorëve në një shumë deri në (pesëdhjetë përqind) 50% të honorarit themelor nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit , për vitin 2013.Ndërsa për zyrtarët e lartë të Kompanisë Bordi miraton kompensimin stimulues në bazë vjetore (për 2013) në një shumë prej 10% nga kompensimi bazë mujor i përcaktuar për Zyrtarët nga pika 11.1, 11.2, 11.3, 11.4 dhe 11.5, në Deklaratën për politiken e kompenzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU”Hidroregjionit Jugor”.

- Bordi i Drejtorëve pasë shqyrtimit të bërë ka **Aprovuar-miratuar** Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat financiare të Audituarra për 2013 dhe letrës për menaxhmentin të bërë nga Auditori i Jashtëm.
- Është bërë shqyrtimin dhe aprovimi i raportëve tremujore për vitin 2014 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore te Ligjit per NP .
- Janë dorëzuar te aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (MZHE); (nga raporti TM1 deri te raporti për TM4),dhe Raporte mujore për ZRRUM-in;

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2014

- Bordi i Drejtorëve ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë.
 - Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkte por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
 - Është mbikqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshëfin Ekzekutiv.
 - Në takimet e rregullta janë mbikqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
 - Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me 19.06.2014,në përputhje me nenin 95 të Ligjit e Punës në Kosovë Nr. 03/L-212,dhe nenit 7, alineja 2 e Statutit të Kompanisë,pasi e shqyrtoj **Aprovoj** njëzëri “RREGULLOREN MBI PËRGJEGJËSIN DISIPLINORE DHE MATERIALE TË PUNËTORËVE TË K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. – Prizren.
 - Bordi i Drejtorëve i Kompanis Rajonale të Ujësjiellit”Hidroregjioni Jugor”Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për Raportet mbi Përmbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike, me VENDIM pas shqyrtimit të bërë ka Aprovuar-miratuar Raportin mbi Sondazhin për Hulumtim të Opinionit për Kënaqshmërinë e Konsumatorëve me Sherbimet e KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh.A, njëzëri pa vërejtje(për vitin 2013).
 - Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2014 i ka mbajtur 10 Takime të rregullta me përbërje të plotë.
 - Në kuadër të Bordit të drejtorëve kanë vazhduar të funksionojnë këto komitete;
1. Komisioni i Auditimit (09 Takime)
 2. Komiteti për hulumtime dhe teknologji (08 Takime) dhe
 3. Komiteti i financave (09 Takime).
 4. Komiteti për staf dhe shperblime(03 takim)

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshëfin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirnjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KfË, USAID), MZHE dhe Kuvendet Komunale për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

Komisioni I Auditimit ka mbajtur nëntë takime të rregullta, sipas procesverbaleve takimet e KA janë mbajtur ne këto data:24.02.2014; 12.03.2014; 23.04.2014; 07.05.2014; 15.07.2014; 15.08.2014; 15.10.2014; 30.10.2014; 25.11.2014.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit, të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet dhe punët të cilat i ka realizuar gjatë vitit 2014.

Bazë apo burim i të dhënave gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Komisionit të Auditimit.

Edhe përkundër faktit se Komisioni i Auditimit që nga viti 2011 aktivitetin e vet e ka kryer me vetëm dy anëtarë, megjithatë konform funksionit dhe kompetencave ligjore që ka, konsiderohet se ka qenë mjaft aktiv, konstruktiv dhe frytdhënës, duke shqyrtuar, diskutuar dhe duke marrë vendime shumë të rëndësishme për kompaninë, si në aspektin e mbarëvajtjes por edhe të ngritjes së performancës së përgjithshme.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjithsejt nëntë (9) takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Në vazhdim, në mënyrë kronologjike, në formë të përgjithësuar, janë të paraqitura takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit.

Në takimin e parë të këtij viti, të mbajtur me 24.02.2014, është diskutuar dhe analizuar:

- Raporti vjetor financiar i Kompanisë, për vitin 2013,
- Raporti vjetor 2013, i punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm,
- Plani strategjik 2014-2016 dhe plani vjetor 2014 i Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Miratimi i draft raportit financiar të Kompanisë për vitin 2013, njëherit sygjeron menaxhmentin që për mbledhjen e radhes të Bordit të Drejtorëve të jetë drafti final i performances financiare.
- Aprovimi i raportit vjetor për vitin 2013 të punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe njëherit rekomandon Bordin që në takimin e radhës të aprovoj raportin vjetor të A.B.
- Aprovimi i planit strategjik të punës së A.B për periudhen 2014-2016 dhe Planit Vjetor të punës për vitin 2014.
- K.A kërkoj që kërkesat e menaxhmentit për financim mbi 5,000€ duhet t'i sillen K.A për aprovim para procedurave të tenderimit.

Takimi i dytë i K.A është mbajtur me datë 12.03.2014, ku është bërë:

- Shqyrtimi i draft raportit të auditimit për kompensimet e Bordeve të Drejtorëve të NPQ për periudhën 2009-2012 nga ZAP.
- Shqyrtimi i raportit final të auditimit nga A.B lidhur me menaxhimin e procesit të pagave.
- Shqyrtimi i propozimit të Menaxhmentit për shpërblim të punonjësve për vitin 2013.
- Informatë nga A.B për ecurin e projektit "Ndertimi i Impiantit për trajtimin e Ujrave të zeza".

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- K.A shqyrtoj draft raportin e auditimit për kompensimet e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për periudhën 2009-2012 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. K.A autorizon A.B, shefin e kontabilitetit dhe një përfaqësues i zyres ligjore të realizojnë një takim me përfaqësuesit e ZAP-it të cilët kanë bërë auditimin për kompensimet e Bordeve të Drejtorëve në menyrë që të ballafaqohen argumentet e Kompanisë me të ZAP-it dhe në bazë të konkluzioneve të cilat arrihen në takim, K.A në takimin e Bordit do të paraqes analizë zyrtare për draft raportin e auditimit të Zyres së auditorit të përgjithshëm.
- K.A aprovon raportin e A.B lidhur me menaxhimin e procesit të pagave dhe sugjeron që në takimin e Bordit të jetë arsyeshmëria dhe përshkrimi i ngritjes së koficientëve në bazë të vendit të punës. K.A sugjeron Bordin që në takimin e radhës të shqyrtoj mundësin e plotësimit apo ndryshimit të sistematizimit të vendeve të punës në bazë të kërkesës së menaxhmentit.
- K.A në bazë të propozimit të menaxhmentit të Kompanisë të dërguar në komitet për staf dhe shpërblime aprovon propozimin e njëjtë me një punëtor shtesë për shpërblime në menyrë lineare dhe njëherit kërkon

nga menaxhmenti i Kompanisë në takimin e Bordit këtij propozimi t'ia bashkangjesin edhe kriteret që janë marrë parasysh për shpërblime.

- K.A falenderon A.B për auditimin e bërë në projektin Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e Ujrave të zeza dhe njëherit sqaron se KRU "Hidroregjioni Jugor" në këtë projekt është përfitues dhe monitorues në realizimin e projektit dhe se nuk ka ndikime të tjera sekondare në përcaktimin e përfituesve të tenderit në bazë të raportit të Auditorit të Brendshëm.

Takimi i tretë është mbajtur me datë 23.04.2014, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi raportit financiar të Kompanisë për tremujorin e parë të vitit 2014,
- Shqyrtimi i raportit tremujor (2014) të punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm,
- Shqyrtimi i deklaratës për politikën e kompenzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e HRJ-së.
- Kërkesa e Auditorit të Brendshëm për ndryshim të planit të Auditimit.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave K.A ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- K.A aprovoj-miratoi raportin e performancës financiare për tremujorin e parë të vitit 2014, pas analizës dhe shqyrtimit të bërë.
- K.A sugjeron menaxhmentin e Kompanisë që në raportet e ardhshme tremujore të sillen në K.A edhe diskutimet, analizat, arsyet e arritjes apo mosarritjes së performancës nga ana e menaxhmentit. Njëherit Komisioni kërkoj që të bëhet praktikë e punës që çdo herë para takimit të K.A për tremujor menaxhmenti të mbaj takim dhe me procesverbal të takimit të raportoj në K.A.
- K.A kërkon që në takimin e radhës të Bordit menaxhmenti të informoj Bordin për masat që janë ndërmarrë për performancën jo të mirë të Nj. së Suharekës dhe të Dragashit.
- K.A sugjeron menaxhmentin e Kompanisë që për takimin e ardhshëm të Komisionit dhe të Bordit të paraqesin propozime konkrete rreth punës së ekipes së kontrollës sepse sipas K.A ekipet e kontrollës nuk janë duke e arsyetuar punën e tyre.
- K.A aprovoj raportin tremujor të punës së A.B, si dhe aprovon auditimet e kryera gjatë TM 1.
- K.A aprovoj Deklaratën për politikën e Kompenzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU "Hidroregjionit Jugor" sh.a dhe të njëjtën propozon të aprovoj edhe B.D.
- K.A aprovon kërkesën e A.B dhe lejon të vazhdohet me auditime të fushave tjera në pajtim me planin vjetor të të paraparë për vitin aktual 2014.

Takimi i katërt është mbajtur me datë 07.05.2014, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi i kërkesave të Kompanisë për inicim të proceduarve të prokurimit me vlerë mbi 5000€.
- Shqyrtimi i kërkesës së Menaxherit Rajonal për Konsumator për rritje të koficienteve për inkasantet dhe punëtorët ne portoarkë

Pas shqyrtimit të këtyre pikave K.A ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Duke u bazuar në autorizimin e Bordit që K.A të shqyrtoj çdo kërkesë të inicimit të aktivitetit të prokurimit për investime me vlerë mbi 5000€ si dhe sipas kërkesave të menaxhmentit të kompanisë për lejin e inicimit të proceduarve të prokurimit K.A merrë konkluzion, me të cilin e lejon menaxhmentin e kompanisë për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme të prokurimit për projektin e furnizimit me karburante për veturat, makinat e punës, gjeneratorët dhe nxemjen qendrore të kompanisë, projektin shërbim me eskavator për hulumtim dhe nevojat e tjera të kompanisë si dhe projektin hapja e puseve piezometer si dhe puseve eksploatuese sipas nevojës së kompanisë.
- Me të cilin K.A duke u bazuar në kërkesën dhe arsyeshmerinë financiare të dhënë me shkrim nga Menaxheri rajonal për konsumator në parim e aprovon rritjen e koficientit për 0.5 për inkasantet dhe punëtorët e porto-arkës, njëherit sugjeron menaxhmentin e kompanisë që në takimet e radhës të K.A dhe të B.D të vijnë me një kërkesë për rishikim të nivelizimit të pagave që janë bërë në vitin 2010. Kërkesën e njëjtë i propozon Bordit ta aprovoj në takimin e radhës.
- K.A e aprovon kërkesën e komisionit për rivlerësimin e materialit të ujës-jellës në depon Qendrore të Kompanisë dhe asgjësimin (zhverësimin) e materialit jashtë përdorimit dhe e procedon si pikë te rendit të ditës për shqyrtim në takimin e radhës të B.D.

Takimi i pestë i K.A është mbajtur me datë 15.07.2014, ku është bërë:

- Shqyrtimi dhe diskutimi i kontrates se auditorit të brendshëm,
- Shqyrtimi i performancës operative dhe financiare për tremujorin e dytë.
- Shqyrtimi i raportit të auditimit lidhur me procesin e raportimit.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- K.A pasi bëri vlerësimin pozitivë të kryerjes së detyrave të punës së zyrtarit të Auditimit të Brendshëm vendosi njëzëri që kontrata e punës së Auditorit të Brendshëm të i vazhdohet edhe për tri vite të tjera prej datës 04.08.2014 deri 04.08.2017.
- K.A aprovon raportin e performancës financiare për tremujorin e dytë me vërejtje, sygjeron menaxhmentin të kryej një rishikim për arsyeshmërin financiare të arritjes apo mos arritjes financiare si dhe kërkon nga Menagjmenti të jepë sqarime më detale për rënjen e inkasimit për tremujorin e dytë. K.A i sygjeron Bordit që ta aprovoj këtë raport financiar, në takimin e radhës.
- K.A aprovon raportin e A.B lidhur me procesin e Raportimit, raporte këto të cilat dërgohen në NJPMNP dhe ZRRUK gjithashtu kërkohet që nga ana e Zyrtarit të lartë për raportim të bëhet identifikimi i subjektit që ka ndikuar në arritjen apo mos arritjen e rezultateve.

Takimi i gjashtë i K.A është mbajtur me datë 15.08.2014, ku është bërë:

- Raporti gjashtëmujor i punës së Auditorit të Brendshëm.
- Raporti i auditimit lidhur me udhëtimin e punonjësve në Shqipëri.
- Raporti i performancës së KRU" Hidroregjioni Jugor" për vitin 2013, dhe
- Revidimi i plan-biznesit 2014-2016.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- K.A e aprovon raportin gjashtë mujor të punës dhe aktiviteteve të zhvilluara nga auditorit të brendshëm, me rekomandimin që në takimin e radhës së Komisionit të Auditimit të përgaditet raport për implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e audituara në këtë gjashtë mujor.
- K.A e aprovon raportin e Auditorit të Brendshëm lidhur me udhëtimin e punonjësve në Shqipëri, njëherit kërkoj që ky raport të jetë pikë e rendit të ditës në takimin e radhës së Bordit të Drejtorëve. Për takim të Bordit kërkoj që këtij raport ti bashkangjiten dëshmit si procesverbali i menaxhmentit, vendimi i marrur i Kompanisë, njoftimi i punëtorëve etj.
- K.A aprovon raportin njoftues të Auditorit të Brendshëm për performancën operative dhe financiare të kompanisë "Hidroregjioni Jugor" për periudhën kohore janar - dhjetor 2013.
- K.A duke u bazuar në sygjërimin e dhënë në takimin e kaluar të Bordit të drejtorëve e sheh të arsyeshme dhe atë duke u bazuar në performancën e mirë të Kompanisë të arritur gjatë vitit 2013 si dhe duke u bazuar në Deklaratën për politiken e kompensimit për Drejtorët e Bordit (të aprovuar në KA dhe në Bord), se janë plotësuar kushtet për shfrytëzim të bonuseve për vitin 2013 nga Bordi ashtu siq janë paraparë në Ligjin mbi NP.
- K.A i paraqet Bordit që të shqyrtoj mundësinë e shfrytëzimit të bonuseve nga zyrtarët e Kompanisë sipas përqindjes së aprovuar në Deklaratën për politiken e kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU" Hidroregjionit Jugor".
- Pas shqyrtimit të bërë K.A e aprovon draft planin e biznesit për 2014-2017 të reviduar, mbetet që ky draft të paraqitet si pikë e rendit të ditës në takimin e radhës së Bordit të Drejtorëve.

Takimi i shtatë i K.A është mbajtur me datë 15.10.2014, ku është bërë:

- Shqyrtimi i raportit të punës së Auditorit të Brendshëm për TM3-2014.
- Shqyrtimi i performancës financiare të Kompanisë për TM3-2014.
- Raporti i Auditorit të Brendshëm lidhur me adresimin e rekomandimeve për periudhën janar – qershor 2014.
- Shqyrtimi i kërkesës së prokurimit për aprovimin e inicimit të aktivitetit të prokurimit për përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për vitin 2014.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- K.A pas shqyrtimit të bërë aprovon raportin e punës së A.B për TM3-2014.

- K.A aprovoi raportin financiar të Kompanisë për TM3-2014, por rithekson se para paraqitjes së TM3 për shqyrtim në K.A duhet aprovuar në menaxhment dhe ai procesverbal i takimit të menaxhmentit të paraqitet në material të TM3. Poashtu kërkon raport për masat e propozuara sa janë realizuar apo implementuar dhe të paraqitet në takimin e radhës.
- K.A kërkon nga menaxhmenti i kompanisë të bëjë një analizë se a ka hapësirë Hidroregjioni Jugor të operoj me tarifa të ujit të ndryshme lidhur me furnizimin me uji të pijes për konsumatorë të ndryshëm dhe të paraqitet në takimin e radhës së Komisionit të Auditimit.
- K.A aprovoi raportin i Auditorit të Brendshëm lidhur me adresimin e rekomandimeve për periudhën janar-qershor 2014 dhe njëherit sygjeron A.B të përcjell implementimin e rekomandimeve edhe për periudhën e ardhshme gjashtë mujore të vitit 2014 (raporti i implementimit të rekomandimeve të paraqitet në fund të vitit 2014).
- K.A pas shqyrtimit të bërë aprovoi kërkesën për inicim të aktivitetit të prokurimit për përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm i cili do të bëjë auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë për vitin 2014.
- K.A aprovoi kërkesën e A.B për auditimin e procedurave të prokurimit për projektet e financuara nga MZHE për vitin 2014.

Takimi i tetë i K.A është mbajtur me datë 30.10.2014, ku është bërë:

- Shqyrtimi i draft Planit të Biznesit për vitin 2015-2017 të Kompanisë,
- Strategjia për rritje të efikasitetit në inkasim (2015-2017).
- Ri-shqyrtimi i raportit të tre-mujorit të tretë 2014.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- K.A aprovoi në tërësi draft plan-biznesin për 2015-2017 pas prezantimit nga Zyrtari për raportim, njëherit rekomandon Bordin që në takimin e radhës të diskutohet dhe aprovohet i njëjti.
- K.A kërkoj që të finalizohet strategjia për rritje të efikasitetit në inkasim për 2015-2017 dhe të paraqitet në takimin e radhës për diskutim njëherit edhe ti prezantohet Bordit, me sygjërim që në radhë të parë strategjia të aprovohet nga menaxhmenti dhe Kryeshefi Ekzekutiv me procesverbal si dhe të parashihet roli i Bordit dhe K.A.
- K.A aprovoi raportin e TM3-2014, pas prezantimit nga Zyrtari për raportim për përmirsimet të cilat janë implementuar në raport, njëherit i sygjëron Bordit që të aprovoj në takimin e radhës.

Takimi i nëntë dhe i fundit i K.A, i mbajtur gjatë këtij viti ka qenë me datë 25.11.2014, ku është bërë:

- Shqyrtimi i performancës operative dhe financiare për muajin tetor 2014.
- Shqyrtimi dhe aprovimi i planit strategjik 2015-2017 dhe planit vjetor 2015 të A.B.
- Shqyrtimi i raportit të A.A lidhur me auditimin bërë në shërbimin me konsumatorë.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- K.A në bazë të raportit të prezantuar nga Zyrtari i lartë për raportim, aprovoi performancën operative dhe financiare të Kompanisë për muajin tetor 2014, njëherit sygjëron Bordit të njëjtën ta aprovoj në takimin e radhës me një informacion dhe arsyesheri lidhur me rritjen e shpenzimeve të gjitha kategoritë.
- K.A njëzëri aprovoi planin strategjik të punës së auditorit të brendshëm, për periudhën 2015-2017.
- K.A njëzëri aprovoj planin vjetor të punës së A.B, për vitin 2015.
- K.A njëzëri aprovoj raportin final të auditorit të brendshëm, lidhur me menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit. K.A sugjeron menaxherin rajonal për konsumatorë të paraqesë sqarim për formën e faturimit vetëm me tarifë fikse të konsumatorëve në fjalë, njëherit kërkon që të angazhohen ekipet e kontrollës në terrenin e inkasimit me nr.3,5,8,9,13,17 dhe 18 në mënyrë që të vërtetohet saktësia e leximit të ujmësve dhe shfrytëzimit të shërbimit të ujësjellësit.

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	28.01.2014	Prizren	
2	14.03.2014	Prizren	
3	29.04.2014	Prizren	
4	19.06.2014	Prizren	
5	26.06.2014	Prizren	
6	15.07.2014	Prizren	Mbledhja e Pergjithshme vjetore me Aksionarin
7	04.08.2014	Prizren	
8	20.08.2014	Prizren	
9	16.10.2014	Prizren	
10	31.10.2014	Prizren	

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	24.02.2014	Prizren	
2	12.03.2014	Prizren	
3	23.04.2014	Prizren	
4	07.05.2014	Prizren	
5	15.07.2014	Prizren	
6	15.08.2014	Prizren	
7	15.10.2014	Prizren	
8	30.10.2014	Prizren	
9	25.11.2014	Prizren	

MBLEDHJET E KOMITETIT TË FINANCAVE
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	24.02.2014	Prizren	
2	15.04.2014	Prizren	
3	11.06.2014	Prizren	
4	09.07.2014	Prizren	
5	27.08.2014	Prizren	
6	22.09.2014	Prizren	
7	29.10.2014	Prizren	
8	25.11.2014	Prizren	
9	26.12.2014	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	21.02.2014	Prizren	
2	15.04.2014	Prizren	
3	11.06.2014	Prizren	
4	09.07.2014	Prizren	
5	27.08.2014	Prizren	
6	18.09.2014	Prizren	
7	26.11.2014	Prizren	
8	26.12.2014	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR STAF DHE SHPERBLIME
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	06.03.2014	Prizren	
2	11.06.2014	Prizren	
3	10.12.2014	Prizren	

II. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

2.1 AKTIVITETET KRYESORE TË NDËRMARRA GJATË VITIT 2.1.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI TEKNIK

FURNIZIMI

Gjatë vitit 2014 furnizimi me ujë ka qenë prej burimet e vjetra dhe nga shtimet e kapacitetve të reja të ujit, përmes shpimeve të pueseve, kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë në nivel të regjionit të Prizrenit.

Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në vitin 2014 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit, dhe kemi pasur reduktime brenda ditës (*Kryesisht Laxha Dardania*).

Në Njësitë tjera Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pasë probleme me furnizim me ujë të pijes duke u bazuar në raportet e Njesive Operuese kemi patur furnizim të rregullt me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për vitin 2014 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **17,482,699.00 m³** krahasuar nga viti 2013 kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej **1,790,916.00 m³**. Janë duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë. Rritja e prodhimit të ujit prej 9.29% është i lidhur me nevojat për konsum, si dhe kanë ndikuar hapja e puseve nga bizneset në njesin e Prizren psh. Hapjet e puseve: "ABI-Center", "Abi Elif" "Super Viva", "Spitali", "SHFMU-Zhurë, EuroFudi", " Fabrika e Bukës", "IFS"-(ish Perllanka) etj, kurse në njesit tjera në bazë të raporteve kemi pasur rritje të prodhimit, ndërsa në njesia Dragashit kemi rritje të prodhimit për shkak të levizjeve të popullsisë.

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfidë kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.

Gjatë këtij viti Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektorët e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogelimin e UPF-së dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për vitin 2014 është **58.93% ose 0.87%** me rritje të UPF nga viti paraprak.

Faturimi në nivel regjional për vitin 2014 është prej **7,180,809.00m³** me një rritje të faturimit prej **567,871.00 m³** krahasuar nga viti paraprak.

*Aktivitetet e shërbimit Teknik në nivel regional kanë qenë të orientuar në mundësinë e furnizimit sa më të rregullt me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët që kjo kompani i mbulon, si dhe në aktivitetet teknike për zvogëlimin e humbjeve si atyre teknike poashtu dhe atyre administrative respektivisht zvogëlimin e vlerave të UPF-së.

*Në njesinë punuese të Prizrenit gjatë vitit 2014 ka pasur aktivitete në nderhyrjet në rrjetin e ujësjellesit dhe të kanalizimit: eliminimin e defekteve në rrjetin sekondar dhe primar, pastrimi dhe fryrje të rrjetit me kompresor, kontrollimi dhe pastrimin e pusetave, kontrollime dhe pastrime të kanalizimit, si dhe riparimet të rrugëve etj.

*Projekti i financuar nga komuna e Prizrenit „Sheshi i Lidhjes“ projekt ky i cili parashihet vendosjen e një gypi transportues të ujit Ø 400mm dhe Ø 125mm si dhe projektin e ujërave fekale sipas projektit të përpiluar nga zyra e konsulencës, punimet janë në përfundim. Prite të bëhet inspektimi me CCTV dhe pastaj të konstatohet funksionimi i tij.

*Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar punimet në rrugën „Fetah Gega“ dhe „Kadri Nesho“ punimet kanë përfunduar siq janë parapara me kontratë duke u realizuar në tërësi punimet si dhe është bërë pranimiti teknik i punimeve. Projekt ky i investuar nga Qeveria e Kosovës, kompania fituese është Fanaj Engineering dhe kanë përfunduar punimet në kohën e paraparë. Dokumentacioni është dorëzuar në MZHE.

*Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për ujë në takim me Vera Muhaxherin është dërguar lista e projekteve prioritare në nivel regional. Në këtë listë është specifikuar edhe projekti i Digës së Manastiricës i cili me një kapacitet prej 1,000,000 m³ ujë të deponuar do të ishte një zgjidhje me afatgjatë për furnizimin me ujë të pijes për qytetin e Prizrenit. Ky projekt i njëjti me kërkesë të MZHE-së është proceduar edhe për BERZH-Banken Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

*Në gjatë vitit 2014 është bërë perurimi i rrjetit të ri në lagjen e Dardanisë për furnizim me ujë për shkollën e Komptencës dhe për një pjesë të lagjës së lartë të Dardanisë, investim i realizuar nga bashkëfinancuesit Kuvendi Komunal në Prizren dhe Hidroregjioni Jugor në Prizren.

*Ka përfunduar edhe pjesa e dytë e projektit të investuar nga MZHE Hapja e puseve të livadhet, me çrast dhe është dorëzuar komplet dokumentacioni në MZHE.

*Projekti i radhës me KfW-në Eficienca në Energjinë elektrike; është në fazën e përzgjedhjes së ofertuesëve.

*Zhvillimi i punimeve në ndërtimin e Rezervuarit V= 2 × 1500 m³ - Lidhja e gjashtë puseve me Rezervuarin, është hap kanali përgjatë vijës së puseve, janë vendosur gypat e ujit me dimensione sipas sasisë së ujit të secilit pus deri në hyrje kryesore në Rezervuar, e poashtu edhe rrjeti elektrik është instaluar i veçantë për secilën pompë dhe vazhdon deri te komanda kryesore e cila do të jetë në objektin përcjellës të Rezervuarit.

*Gjatë këtij viti është bërë mbushja dhe testimi i rezervarëve, mbushja e rezervarit me ujë është bërë nga dy puset, duke rezultuar në gjendje të rregullt. Njëherë është bërë edhe testimi i gypit të ujësjellesit nga rezervari "Krismat e Sali Shabanit" deri në Gelanc duke u mbushur me ujë gypi DN-315 dhe është bërë testimi pjesë – pjesë.

*Hapja e pusit në Bukosh dhe vendosja e pompës - Pas hapjes së pusit në fshatin Bukoshë është montuar pompa 3.2kw për testim të pusit, pasi që në afërsi të pusit nuk ka rrjet elektrik pompa ka punuar me gjeneratore derisa është bërë pastrimi i pusit. Në bazë të kapacitetit të pompës nga pusi janë duke u nxjerrë 3.8-4.0l/s dhe gjatë kohës së testimit niveli i ujit ka qenë shumë i stabil.

*Gjatë këtij viti janë zhvilluar punimet në ndërtimin e galerisë së re të ujit në pjesën mbi Rezervuarin "Krismat e Sali Shabanit" në Baçevc. Pas përfundimit të punimeve në ndërtimin e tunelit të galerisë, përgjatë pjesës ku kanë qenë të hapura puset e ujit, galeria është vazhduar edhe për një gjatësi prej 30m më poshtë, në mënyrë që të lehtësohet qasja në brendësi të galerisë, ndërsa mbetet të mbulohet krejtësisht nga e sipërme.

*Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen "Rruga e Reqanit" në Suharekë-Në bazë të marrëveshjes në mes të Komunës së Suharekës dhe K.R.U."Hidroregjioni jugor", Njësia në Suharekë për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në Suharekë, në lagjet "Rruga e Reqanit" dhe në Shirokë, si dhe rregullimin e defekteve në fshatrat Greikoc dhe Leshan.

*Investimet - gjatë vitit 2014 në kompanin e "Hidroregjionit Jugor"njësia në Dragash kemi pasur zhvillimin e punimeve ndrrimin e gypit kryesor nga udhëkryqi i fshatit Lybevisht deri te Bibloteka e qytetit në Dragash,gjatësia e gypit 300 m,fi 250, vlera e investimit 13.000,00 euro.

*Vazhdimi i punimeve të ujësjellësit të ri nga Filtrat deri te rezervuari në fshatin Rrenc,ku janë investuar mbi 220.000.00 euro.

*Gjate kësaj periudhe (30.01.2014) është nënshkruar kontrata ne mes kryetarit të komunes te Dragashit, Hidroregjionit jugor dhe perfaqesuesit te fshatit Brezne per marrjen në menagjim sistemin e furnizimit me ujë. Pas marrëveshtjes ekipet tona kan dalur ne teren dhe kan verifikuar gjendjen, duke lidhur kontarata, ndërrimet e ujëmatësave, bllobimet etj.

*Shpimi i puseve testuese në fshatin Pagarushë- fi 225 mm = 3 puse ,gjithësejtë : L=220 m, Hulumtimi i burimeve te ujit me qëllim të furnizimit me ujë të banorëve të fshatit Pagarushë,Marali dhe Guriq.=4.750 banorë .Këto tri puse janë hapur por ende përshkak te kushteve atmosferike nuk është bërë elaborati për sasinë –kapacitetin uJOR . Besojmë që janë dikund mbi 15 l/s . Vlera e projektit është =12.000.00€ (KK.Malishevë).

*Aktivitete lobimi Kontakte te rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe ate të Urbanizmit,Takim me perfaqësuesit e fshatit Drenoc ku edhe kanë filluar punët në montimin e pusetave dhe ujëmatëve individual nga N.N.BELI, Investitorë: IRD , K,K.Malishevë dhe HRJ .

*Investimet e vazhdueshme në rrjetin e ujësjellësit me qëllim arritjen e objektivave tona si kompani në zgjerimin e shërbimve tona.Si rezultat i bashkëpunimit tonë me Komunën dhe donatorët këtë vit /2014 ,kemi arritur ta realizojmë dhe imlementojmë projektin "Rrjeti i ujësjellësit në Fshatin Drenoc 32km rrjet primar dhe sekondar " ,ku me ujë do të furnizohen rreth 6000 banorë.Vlera e këtijë projekti kapë shumën prej 450.000 €.Investim i realizuar nga K.K .IRD.Kisha Amerikane dhe HRJ. Në fund të dhjetorit 2014 kemi qenë në fazen e ndërtimit të pusetave dhe montimit të ujëmatësave.

*Takime të vazhdueshme me CDI-ne per projektet që do të financohen nga qeveria Zviceriane dhe R. E Kosoves, në këtë takim është diskutuar lista e projekteve për të gjitha komunat ku operon HRJ, me ç`rast dhe është berë ndarja e projekteve për rehabilitimin e sistemeve ekzistuese dhe ndertimi i sistemeve të reja të ujesjellësit, në theksë të veçant në fazen e parë do të investohen vetem në ato fshatra të cilat nuk janë nën menaxhimin e HRJ-ne.

*Vizite ne teren neper punishtet ku jane duke u zhvilluar punime me çrast dhe eshte bere inspektimi i punimeve nga inxhinieret e kompanise. Momentalisht jemi duke i zhvilluar projektet e investuara nga MZHE, dhe kemi raportuar konform kerkesave te MZHE-se.

*Gjatë vitit është bërë leximi i ujëmatësave zonal me qellim per te verifikuar hargjimet të ujit nëpër zonat e veçanta.

*Takim ne ZRRUK ku tema e takimit ishte informatat shtese lidhur me Planin e Biznesit 2015-2017, në këtë takim u vendos qe të jepen pershkrimet të projekteve të perfshir në bazë të Plan Biznesit 2015-2017.

*Pjesemarrja ne evalumin e tenderit per inspektimin dhe vleresimin e fshatrave te financuar nga Qe Kosoves dhe ajo zviceriane me implementues CDI-DORCSH. Ekzistojne raportet shtese.

*Pershkrimi i projektit per Biznes Planin rregullator tarifor 2015-2017. Posedojme planin rregullator

*Hartimi i paramasave dhe parallogarive per rehabilitimin e rrjetit te ujesjellesit ne rruget qendrore te ujesjellesit i cili eshte regjistruar ne PIP-Programin e Investimeve publike ne MZHE per vitin 2015-2017.

*Vizite ne Prishtine me rastin e inaugurimit te investimeve te Qeverise Gjermane-KfW.

Hartimi i projektit per ndrrimin e gypit ekzistues O300mm me ate PE 315 me L=1050m, projekt ky i hartuar nga inxhinieret e kompanise.

*Udhetimi i dy ing.Lulzim Paçarizi dhe Lumni Sallahu per në Japoni ne lidhje me ngritjen e kapaciteteve ne sektorin e trajtimit te Ujerave të ndotura.

2.1.2 AKTIVITET E SHERBIMIT TEKNIK TE NDERMARRË PËR ELEMINIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e te gjithe konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithe konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

Raport nga Menaxheri i projekteve - programit mbeshtetës për zanat rurale

Faza V.

Projekti : Programi Mbeshtetes për ujë dhe Kanalizim në zonat Rurale Faza e V-te

Investues : Qeveria Zvicrane dhe Qeveria e Kosoves

Implementues:Dorsch Gruppe (Dorsch International Consultants) nga Gjermania dhe CDI (Community development initiatives) nga Kososva. Ekipi i stafit Nderkombetar dhe Vendor.

Vlera e pergjithshme e investimeve 17,000.000. Euro, për shtatë Kompanit Rajonale të Kosovës.

Qellimi: Sherbimet publike te Kosovës të mbuloj me furnizim me ujë te pijshem, pjesen me te madhe te popullesis në tërë vendin, dhe të menagjoj sistemin e trajtimit te ujrave te zeza ne pilot projektet.

Programi Mbeshtetes për Ujë dhe Kanalizim për Zonat Rurale në Kosovë -Faza e V-te do të jet katër vjeçar.

*Programi do të ketë disa komponente :

*Komponente e parë - përfitues do të jenë fshatrat që nuk kanë farë sistem të ujesjellësit

*Komponente e dytë – Fshatërat që kanë sistem të ujesjellësit por kanë nevojë të rehabilitohen per të qenë plotësisht funksionale.

*Komponente e tretë-Ndërtimi i impianteve biologjik per trajtimin e ujrave të zeza në zonat rurale - pilot projekte (kater fshatra në nivel të Kosovës)

*Komponente e Katër – Fushat vetëdijesimit për përdorimin e ujit,kualitetin e ujit.

*Caktimi i Anëtarëve të Grupit punues.

Implementuesit e programit kërkuan që të caktohen nga një antarë i Kuvendeve Komunal edhe Hidroregjioni Jugor me kompetenca të plotë për të marrë pjesë në grupin e punës .

Antarët e Grupit punues;

1. Zenel Zenelaj –“Hidroregjioni Jugor” Prizren.

2. Florim Krasniqi , Drejtor i Urbanizmit - K.K. Dragash

3. Nexhat Ramadani , Drejtor i Sherbimeve Publike - K.K. Suhareke

4. Urim Kastrati, Drejtor i Urbanizmit - K. K. Malisheve

5. Hasan Hasani, Drejtori i sherbimeve Publike - K.K. Prizrenit

Në takim e mbajtur në mes Iplementusve të programit, Kryetarëve të Komunave “Hidroregjionit jugor” u diskutuan :

*Fshatrat te cilat nuk kanë farë ujësjellës dhe janë në prioritet dhe njeherit janë mundësit reale për furnizim me ujë , por u mungon sistemet e ujësjellesëve.

*Fshatërat që kanë sistem të ujësjellësit dhe vetë menaxhohen në nivel rajoni.

nr.	Komunat	nr.fshatrave	nr. Banorëve	nr.konsumatorëve	Furnizimi	
					Pomp	Gravitet
1	Prizreni	41	43680	8125	12	29
2	Suharekë	12	26000	3390	8	4
3	Dragash	36	58960	9195	6	30
4	Malishevë	11	17620	2052	5	6
TOTALI		100	146260	22762	31	69

*Dinaika e rrjedhes së aktiviteteve:

*Implementuesit e projektit - Dorsch, CDI dhe Hidroregjionin Jugor , Për Sistemet ekzistuese te Ujësjellësave per zona rurale - fshtrave qe vete menagjohen kane shpall tenderin per vlersimin e gjendjes se sistemeve te ujesjellësave, sipas kriterit te dhenies “çmimi me i ulet “ bazuar ne ligjet e Prokurimit në Republikën e Kosoves .

1.Është përzgjedhur firma: N.N.P “D-PROJEKT“ nga Prizreni përfituese për vlerësimin e sistemeve të ujësjellësave për zonat rural me vlerën 44.660,00 €

Firma: N.N.P. “ D-Projekt “ është në përfundim të vlersimit .

2.Nga implementuesit e programit / Dorsch-CDI/, është publikuar tenderi për furnizim me gypa të ujësjellësit (për ujë të pijes) HDPE100 – RC nga Ø(65-315) mm, me sasi 1.000 km për programin mbështetës për ujë dhe Kanalizim në Zonat Rurale në Kosovë (RWSSP) Faza e V-te.

kanë aplikuar 15 Operator ekonomik , vendor dhe nderkombëtar .

Komisioni i vlersimit ka vlersua tre Operator ekonomik që kanë dorzuar tender të pergjegjshëm :

1.” K-ING”&”XERXA” nga Prishtina me shumën - 6,085,048.20 €

2.”CENTRALTUB” nga Italia me shumën - 6,156,206.00 €

3.”VODOSKOK”&”ALB KONSTRUKSION” nga Kroacia&Shqiperi -7,242,312.00 € jemi ne pritje të shpalljes së përfituesit për furnizim.

(Menagjeri i projektit - Inxh.dip.ndert. Zenel Zenelaj)

Raport nga Komiteti i projekteve – për ujëra të zeza

*Ecuria e projektit te ujerave te zeza gjegjesisht Impiantit per Trajtimin e Ujerave te Zeza ne Prizren per vitin 2014 eshte pershkruar ne raportet mujore dhe raportet periodike te cilat perpilohen nga Zyra e Konsulences dhe nga komiteti i projektit-KRU”HRJ”sh.a, dhe te cilat jane ne dispozicion tek Komiteti i Projektit,ne Arhive dhe gjenden ne forme te shtypur dhe elektronike.

*Tani po pershkruajm ne pika te shkurtera gjendjen aktuale te ketije projekti ne aspektin e progresit edhe per Fazen I edhe per Fazen II.

*Ky projekt eshte bashkfinancim ne mes te Republikës se Gjermanise dhe Republikës se Kosoves, kurse Komuna e Prizrenit ka bere kompenzimin e pronareve per shpronësimin e lokacionit ku do te ndertohet impianti dhe ate me siperfaqe prej afersisht 12ha ne fshatin Vlashnje.

Projekti ndahet ne 2 Faza:

Faza I- Ndertimi i kolektorit kryesor ne anen e djathte te rrjedhjes se lumbardhit si dhe rehabilitimin e disa pikave problematike ne aspektin e funksionalitetit si ne laxhen Kurilla dhe ne Zonen Industriale.

Faza II- Ndertimi i Impiantit per Trajtimin e Ujerave te Zeza -ITUZ

*Sa i perket projektit per Grumbullimin dhe trajtimin e ujerave te zeza per qytetin e Prizrenit, pothuajse jemi ne fazen fillestare te ekzekutimit te projektit per te dy Fazat.

*Sa i perket **Fazes se Pare** eshte shpallur kompania fituese, PASSAVANT nga Gjermania &KWE nga Kosova si nenkontraktor e cila do te ekzekutoj punet ne teren me rreth 25% te kontates. Per kete projekt eshte nenshkruar Kontrata per pune kryerje ne mes te kompanise fituese dhe KRU"HRJ"sh.a, ne kontrate jane percaktuar te gjitha pozicionet e paramases per punet qe do te kryhen dhe eshte dhene plani dinamik i punimeve, si dhe ne baze te kontrates eshte parapare qe kompanise pune kryese ti paguhet 20% te vleres se kontrates si avans. Deri me tani eshte bere pagesa e 4% te ketije avansi me vlere prej 99,763.70 euro minus TVSH prej 16%, kurse vlere e mbetur e avansit duhet te paguhet sa me shpejte qe eshte e mundur, si kusht per fillimin e punimeve.

*Ne baze te disa takimeve qe kemi patur me kompanine konsulente dhe kompanine pune kryese jemi ne diskutim te zgjidhes se problemit me TVSH-ne pasi qe sipas Marreveshjes se vecant ne mes te KfW, MMPH, HRJ dhe Komuna e Prizrenit, pagesa per kompanine pune kryese duhet te behet nga kontributi vendor te cilin do ta paguaj MMPH.

*Deri me tani ne si Komitet i projektit kemi nxjerre te gjitha lejet dhe pelqimet e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e projektit. Per momentin jemi ne procedure te marrjes se lejeve-pelqimeve per ekzekutimin e punimeve nga niveli Komunal dhe ai Qendror.

*Nga Kuvendi Komunal kemi bere kerkesen ne Drejtorine e Planifikimit dhe Urbanizimit, ku dhe kemi marre nje konkluzion per pelqimet percjellese te cilat nevojiten per marrjen e lejes nga drejtoria e urbanizimit per fillimin e punimeve.

*Nga Ministria e linfrastruktures do te merret pelqimi per pjesen e rruges ku Ministria ka bere zgerimin e rruges dhe ka nderhyre ne vijen tone te kolektorit. Kjo distance eshte 1.2km dhe fillon nga Rrethi per fshatin Hoqe e Qytetit dhe perfundon tek kycja ne Jug te Autostrades.

*Duhet cekur se pjesa problematike e lagjes Kurilla dhe Zones industriale eshte ofertuar pra jane dhene cmimet nga Pune kryesi por ende nuk eshte bere dizajni detal per shkak se keto zona duhet te inspektohen me CCTV te cilat poashtu i ka persiper kompania pune kryese.

*Vlere e kontrates per fazen e pare eshte gjithsejt **2,043,273.00 Euro**, ne kete vlere nuk eshte e perfshire TVSH-ja, qe do te nenkuptonte se kompania Paswante ka ofertuar me kete cmim dhe nese kryhen te gjitha punet e parapara ne paramase duhet te paguhet kjo vlere e sipershenuar.

*Kan filluar parapergaditjet e kompanise implementuese sipas planit dinamik te paraqitur ne kontrate dhe pas takimeve, me crast eshte paraqite bill bordi i cili do te beje pershkrimin e puneve qe do te kryhen ne lidhje me fazen I, qe nenkupton eshte pershkruar donatori, perfituesi i projektit, titulli i projektit dhe emri i kompanise pune kryese, ne gjuhen Angleze dhe gjuhen shqipe. Dimensionet e ketije bill bordi do te jene 1X1.5m dhe do te vendoset ne vendpunishte.

*Sipas planit dinamik punimet parashihen te fillojne nga mesi i muajit Shkurt dhe pritet te perfundojne 365 dite pas kesaje date, po ashtu ne planin dinamik eshte dhene edhe afati i sugirise se punimeve i cili eshte 1 vit, po ashtu jane parapare edhe 5 dite kontrolla gjenerale, ku do te jepet certifikata e perfundimit dhe garancionit te punimeve. Ekziston Plani dinamik i realizimit te punimeve.

*Projekti i financuar nga komuna e Prizrenit „Sheshi i Lidhjes“ ne te cilin jane vendosur kolektoret konform projektit te parapare nga konsulenca dhe HRJ, projekt ky i cili ka perfunduar dhe eshte financuar nga Komuna e Prizrenit.

Ende nuk kemi marr ndonje njoftim nga Komuna e Prizrenit per mbarvajtjen e punimeve, pasi qe Pranimi Teknik duhet te behet edhe nga ana e HRJ-, si dhe patjeter eshte parapare incizimi i kolektorit me kamere. Ne kete projekt ne nje distance prej 230 m eshte vendosur Gypi i Ujesjellesit PE O400mm dhe Gypi i ujesjellesit PE O125mm, si dhe jane vendosur pusetat perkatese.

2.1.3 PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE EMERGJENTE TE KOMPANISE PER TE PERMIRESUAR SITUATEN E FURNIZIMIT ME UJE TE PIJES:

(Shiko tabelen e investimeve)

2.1.4 FURNIZIMI ME UJË NË NJËSITË PUNUESE

Aktivitetet për vitin 2014 - Njesia Prizren

*Furnizimi me ujë ka qenë i rregullët në përgjithësi, përveqë në disa raste kur ka pasë ndonjë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjetit të ujësjellësit dhe gjatë punimeve për pastrimin e ujematësave zonal.

*Prodhimi i ujit: Në këtë vit janë prodhuar 13,562,010.00 m³ ujë ose 430 L/S dhe kjo sasi ka kushtuar furnizim të rregullët për të gjithë konsumatorët përveq në lagjet me sistem pompimit (Kurrilen dhe Dardanisë).

*Humbjet e ujit: Humbjet e ujit arrijnë në 59 % për shkak të rrjetit të vjetër të ujësjellësit, dhe ndërhyrjeve të pa legalizuara.

*Operacionet e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe kanalizimit: Gjatë muajit Janar 2014 furnizimi me ujë ka qenë i rregullët 24 orë duke iu falenderuar aktiviteteve me rastin e shpimit të tri puseve në lokacionin e Bunarit II ku edhe pse kemi ramje të prurjeve natyrore kemi arritur me i zavendesu ujit për 120 l/s dhe e kemi rikthyer furnizimin të rregullët në lagjen "Tusus" furnizim të rregullt 24 orë.

Aktivitetet për vitin 2014 – Njesia Malishevë

*Gjatë gjithë vitit 2014 furnizimi me ujë ka qenë i plotë në të gjitha zonat e shërbimit ,përfshiro Fshatin Lladrofc me 255 konsumatorë ku në periudhën ,Shtator-nëntor/2014 ,rreth 85 konsumatorë të këtijë fshati të cilët janë në pjesët më të larta kanë pasur ujë të pijëshëm vetëm 6 orë / në ditë.Kjo për arsye të rënjes së burimeve të ujit i cili është me gravitacion.

Kualiteti i ujit ,poashtu ka qenë i mirë gjithnjë në përputhje me standardet

*Prodhimi i ujit në m³ gjatë vitit 2014 ka qenë 1.344.602 m³ ose 18.107 m³ më shumë se në vitin 2013 (1.37 % më shumë).Rritja e prodhimit të ujit është për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve për 406 konsumatorë të rinjë .

Aktivitete për vitin 2014 - Njesia Suharekë

*Prodhimi i ujit - Gjatë vitit 2014 ka pasur një rritje të prodhimit të ujit për 231.810[m³] ose 12,16[%], në raport me vitin 2013, kryesisht për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve për 458 konsumatorë.

*Furnizimi me ujë – Viti 2014- Furnizimi me ujë gjatë vitit 2014 ka qenë pa reduktime pothuajse në tërë zonën e shërbimit, duke përfshirë ndonjë ndërprerje të shkurtër për shkak të ndonjë problemi me pompa, si në Samadraxhë që kryesisht po ndodhin për shkak të problemeve me rrymë.Edhe më tutje kemi furnizim jo adekuat në periferi të qytetit të Suharekës dhe atë për shkak të nivelit të ultë të bazenit në Shirokë, prej nga furnizohet qyteti dhe si pasojë kemi shtypje të ultë, ndërsa në pikat më të larta fare nuk ka furnizim.

*Gjatë vitit 2014 janë realizuar 132 mostra të analizave bakteriologjike dhe prej tyre 125 iu kanë përgjigjur standardeve, ndërsa 7 prej tyre jo.

*Rregullimi i defekteve – Viti 2014 - Rrjeti primar ka pasur 4 defekte ,Rrjeti sekondar 410 defekte, Deblllokimi i kanalizimeve 77 ndërhyrje, Stacionet e pompimit 22 defekte, Zëvendësimi i ujëmatësve 5, Rregullimi i kubëzave 74 [m³], Rregullimi i anësoreve 30 [m] gjatësi.

Aktivitetet për vitin 2014 - Njesia Dragash

*Gjatë vitit 2014 Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këtij viti, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në shërbimin operativ.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto: Në rrjetin e ujësjellësit janë 35 raste në sanimin e defekteve.

*Prodhimi i ujit: Në këtë vit janë prodhuar 438.560 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët, edhe pse kemi renje të prodhimit në këtë vit deri 4.91 kja ka ndikuar sipas nevojës së konsumit.

*Humbjet e ujit: Humbjet e ujit këtë vit arrijnë deri në 50.19 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

*Gjatë vitit 2014 në njesinë e Dragashit përkatësisht në fsh. Brezne ka pasur 171 ujëmatës të demontuar për riparuar.

*Është për tu theksuar se afër 400 familje janë larguar nga vendbanimet e tyre dhe kanë shkuar jashtë vendit, gjë që kushtëzon prodhimin e ujit.

*Investimet - gjatë vitit 2014 në kompaninë e "Hidroregjionit Jugor" njesia në Dragash kemi pasur zhvillimin e punimeve ndërrimin e gypit kryesor nga udhëkryqi i fshatit Lybevisht deri te Biblioteka e qytetit në Dragash, gjatësia e gypit 300 m, fi 250, vlera e investimit 13.000,00 euro.

*Vazhdimi i punimeve të ujësjellësit të ri nga Filtrat deri te rezervuari në fshatin Rrenc, ku janë investuar mbi 220.000.00 euro.

2.1.5 PRODHIMI I UJIT m³ viti – 2013- 2014

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	15,580,205.00	42,685.49	494.0	
Suharekë	1,905,717.00	5,221.14	60.4	
Dragash	461,198.00	1,263.56	14.6	
Malishevë	1,326,355.00	3,633.85	42.1	
Total	19,273,475.00	52,804.04	611.2	

2014

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	13,562,010.00	37,156.19	430.0	
Suharekë	2,137,527.00	5,856.24	67.8	
Dragash	438,560.00	1,201.53	13.9	
Malishevë	1,344,602.00	3,683.84	42.6	
Total	17,482,699.00	47,897.81	554.4	

2.1.6 MIRËMBAJTJA E RRJETIT – SANIMI I DEFEKTEVE viti – 2013-2014

2013

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1284	650	1934
Suharekë	274	62	336
Dragash	47	5	52
Malishevë	187	62	249
Total	1792	779	2571

2014

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1113	692	1805
Suharekë	422	68	490
Dragash	35	00	35
Malishevë	336	51	387
Total	1906	811	2717

2.1.7 SHËRBIMIMI I MIRËMBAJTJES–SERVISIMIT TË UJËMATËSAVE: Ø(13 - 100)MM- 2013

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	531	Prej dates 12.03 – 17.03.2013, dy ekipe të demont.-montimit të ujëmatësave janë angazhuar në montimin e ujëmatësave në f.Mushtisht. Kurse prej datës 18-31.03.2013, është angazhuar vetëm një ekip i demontim-montimit të ujëmatësave.
	3/4"	1077	
	1"	137	
	5/4"	4	
	6/4"	2	
	Gjithsejt:	1751	
Suharekë	1/2"	5	
	3/4"	21	
	1"	0	
	Gjithsejt:	26	
Dragash	1/2"	7	7 ndrrime,3montime
	3/4"	35	
	2"	2	
	Gjithsejt:	44	
Malishevë	1/2"	10	3 ujmatasa te ndrruar, ndersa 14 ujmatasa te montuar me vetefinancim
	3/4"	80	
	1"	3	
	Gjithsejt:	93	

Totali : 1914 ujëmatës

2014

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	556	*Stacioni i autobusave: demontim i ujëmatësit Ø80-montim Ø50mm *„Rudina“ export-import: demontim i ujëmatësit Ø100-montim Ø6/4mm *Riparime të ujëmatësive për K.R.U. „Radoniqin“. 1 cope 1/2, 148 cope 3/4, 1 cope 1“, 1 ekspertizë. *Ujëmatësa të riparuar për depo në HRJ.60 cope 1/2, 63 cope 3/4. *Spitali rajonal Dr.Daut Mustafa-Riparim i ujëmatësit 2xØ100mm dhe 1xØ1“mm. *Asambleja komunale-Prizren, pastrim i ujëmatësit Ø50mm. *„Ramateks“ Ø100mm dhe 1“, Riparim të ujëmatësive. *Pastrimi i ujëmatësit të stadiumit të qytetit „Perparim Thaqi“ Ø125mm
	3/4"	1098	
	1"	124	
	5/4"	04	
	6/4"	05	
	Gjithsejt:	1787	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	43	F.Brezne *171 ujëmatësa të demontuar për riparim *95 ujëmatësa të riparuar
	3/4"	90	
	1"	01	
	Gjithsejt:	134	
Malishevë	1/2"	11	
	3/4"	25	
	1"	01	
	Gjithsejt:	37	

1958 copa+ 123+ 325 Radoniqin Totali: =2406 riparime

2.1.8 ZYRA PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllombimet nëpër qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin, kanë arritur këto rezultate.

- *Ujëmatësa të bllombuar 1478 ujëmatësa.
- *Kontrata të nënshkruar 1478 kontrata
- *Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 2557 konsumator.
- *Konsumatorët që ekipa konstatoj që duhet të zavëndsohet ujëmatësi 66.
- *Konsumatorët që janë të bllombuar 1216.
- *Konsumatorët pa ujëmatës 203.
- *Rekorde të reja për blockmapping 420.
- *Konsumatorët që nuk pranojnë të kyçen 01.
- *Konsumatorët me regjistrim të ri 02.
- *Konsumatorët që nuk kanë lidhje uji (me puse) 89.
- *Konsumatorët që duhet regjistruar 26.
- *Konsumatorët me puseta të bllokuar 31.
- *Ribllombim, bllombim për here të dytë 550.
- *Konsumatorët me regjistrim paushall 15.
- *Refreshim të haretës 164.
- *Konsumatorët që duhet bërë aktivizimin e faturës 54.

Nr.	Prizren Total –Gjithesej	Total
1	Bllombim-Kontrata	1478
2	Dera Mbyllyr(Heren e dyte)	2557
3	Puseta të bllokuara	31
4	Pa ujëmatës	203
5	Zavendsime	66
6	Nuk kane lidhje të ujit (me puse)	89
7	Rekorde te reja per blockmapping	420
8	Nuk pranojnë të kyçen	01
9	Regjistrim i ri	02
10	Bllombim për herë të dytë	550
11	Regjistrim paushall	15
12	Bllombimet e më hershme	1216
13	Konsumator që duhet të regjistrohen	26
14	Refreshim të hartës	164
15	Aktivizim i faturës	54

Aktivitete kryesore:

*Në vitin 2014 janë përfunduar në total 12 harta gjithsej 6,188 rekorde, poashtu janë pregaditur edhe 2 harta për programin e GIS-it.

*Në vitin 2014 janë përfunduar 2 harta gjithsej 280 rekorde të reja të regjistruara në database, 6 harta të refreshuara si dhe pregaditja e formulareve për teren.

*Bllombim ne fshatin : Kushnin - Aktivitetet të konsumatorët:Bllombim për herë të dytë 29.

*Ne muajin Janar, grupi i bllombimit po ashtu kane dal ne teren ku kane bere nenshkrime te kontratave te konsumatoret,nen menaxhimin e Hysni Ahmetit,menaxher per konsumator.

*Në muajin Shkurt, demontim,montim,instalim ne fshatin : Brezne-Dragash.

Demontim-Montim,Kontrata,Bllombime: Ujëmatësja $\frac{3}{4}$ = 106 copë, Ujëmatësja $\frac{1}{2}$ = 62 copë, Ujëmatësja 1" = 03 copë

*Instalim,Kontrata,Bllombime: Ujëmatësja $\frac{3}{4}$ = 47 copë, Ujëmatësja $\frac{1}{2}$ = 11 copë

Totali i ujëmatësave në fshatin Brezne-Dragash: 229 ujëmatësja

* Në muajin Mars ka filluar Refreshimi i Hartes 7F121111:Bllombim-Kontrata 03,Dera mbyllyr (Heren e dytë) 16 Të bllombuar me heret 24, Zëvendime 01, Rekorde të reja për blockmapping 07, Bllombim për herë të dytë 04.

*Aktivitetet në fshatin Murademaj : Bllombim-Kontrata49, Instalim të ujëmatësave 23, Demontim-Montim të ujëmatësave 14, Dera Mbyllyr 10, Zëvendime20, Vend i papershtateshem për montim të ujëmatësave 09, Konsumatorët me ujematësja 26, Konsumatorët qe kërkojnë ç`kyqje 03,, Rekorde të reja në harte për Blockmapping 78 rekorde

*Aktivitetet në Komunën e Suharekës :Ujëmatësja të bllombuar 1015 Ujëmatësja, Kontrata të nënshkruar 1015 Kontrata, Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 341 konsumator, Konsumatorët që nuk kanë lidhje të ujit (me puse) 592, Konsumatorët që kanë lidhje të ujit,mirpo nuk kanë sherbime 51, Konsumatorët pa ujëmatësja 141, Konsumatorët që duhet të regjistrohen 27, Konsumatorët me puseta të bllokuara 03, Konsumatorët që nuk pranojnë të kyçen 02, Konsumatorët që duhet të zëvendesojnë ujëmatësin 10, Konsumatorët me shtëpi në ndërtim 06, Konsumatorët të rinjë 01.

*Takim ne Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor ne Prishtine.

*Në muajt Janar-Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njesi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojne dhe montojne 1,488 ujematësja. (ekzistojnë raportet për çdo muaj).

*Në muajt Janar-Dhjetor grupi i dedektimi të rrjetit të ujësjellësit ka bërë gjithësej 540 detektive, gjatë detektimit kanë hasur në 361 defekte, poashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 35,650 m. (ekzistojnë raportet për çdo muaj).

*Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësave zonal për muajt Janar-Dhjetor, ku vlen të përmenden ngecjet dhe pengesat gjatë leximit të ujëmatësave në pikat matëse :

Fehmi Lladrovci (kontrroll,lexim i vogel), ETC-ja (kontrroll,lexim i vogel), Jusuf Gervalla (kontrroll,lexim i vogel), Vlashne (kontrroll,lexim i vogel), Sheshi i Lidhjes (punime në shesh), Atmaxhë (bypass që nga Korriku), Nashec i epërm (nje muaj nuk shihet ujëmatësi për lexim), në KFOR (nje muaj nuk kemi arritur leximin e ujëmatësit).

Pikat tjera janë kontrolluar dhe rezultojnë se të gjithë ujëmatësat janë në gjendje të rregullt për muajt Janar – Nentor. Në muajin Dhjetor e kemi pasur të pamundur të bëjmë leximin e ujëmatësive për arsye të kushteve atmosferike (bore), kështu që mbetet të bëhet leximi i ujëmatësive zonal me date: 15.01.2015.

*Në vitin 2014 kanë qenë 23 raste,që vetë konsumatorët i kanë sjellë ujëmatësat për servisime dhe riparim në zyret e Bazhdarimit, (ekzistojnë raportet e veqanta).

2.1.9 ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE DHE BAKTERIOLOGJIKE

Raporti i laboratorit të analizave nga KRU" Hidroregjioni Jugor"Prizren

Aktivitete tjera: *Kontakte me mjekë mikrobiolog në kuadër të ISHP-Prizren për diskutim rreth analizave që nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijes edhe pse në të gjitha analizat rezultojnë prezenca e klorit residual prej 0.2-0.3mg/l;

*Është njoftuar edhe IKSH-Prishtinë dhe se me Dr.Burbuqe Nushi kemi diskutuar rreth analizave që nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijes dhe se mendimi i saj është se mund të ketë ndonjë infektim sekondar në ato vende ku janë marrë mostrat;

*Për shkak të ndotjes së burimeve në 40 Bunarët më 24.01.2014 kemi bërë shkarkimin e të gjitha burimeve në lum dhe pas 5-6 orë kemi futurë në sistem të gjitha burimet.

*Instalimi i sistemit të klorifikimit në fshatrat Kushnin, Kabash dhe Lubizhd të Hasit si dhe furnizimi i punëtorëve adekuat me komparator dhe DPD-tableta për përcjelljen e klorit residual në rrjetë.

*Takim me përfaqësues të KFOR-it gjerman , përgjegjës për ujë, për marrjen e mostrave në Mulli gjatë instalimit të bombolës 1 t për të konstatuar pastërtinë e klorit gaz dhe identifikimin e ndytësirave që kemi konstatue gjatë instalimit (kopjen e analizave të bëra nga ana e KFOR-it Gjerman i kemi marrë më 07.03.2014);

Takim me përfaqësuesin ndërmintor të ujërave z.Afrim Lajçi dhe përfaqësuesen e IKSH-Dr.Burbuqe Nushi-Latifi ku kemi diskutuar për zbatimin e Udhëzimit Administrativ dhe cilësinë e ujit dhe në lidhje me analizat që janë aktuale (arsyja pse nuk përgjigjerna disa analiza bakteriologjike në vende të caktuara,këtë e kemi diskutuar edhe më herët). Kopjen e konkluzave të mbledhjes JU kam dorëzue;

*Vizita në Prishtinë për sigurimin e kemikateve adekvatë (DPD) për përcjelljen e cilësisë së ujit gjegjësisht klorit residual dhe sigurimi i komparatorëve për të gjithë ata që nuk posedojnë komparator;

*Përgaditja e gjithë dokumentacionit përkatës të kërkuara nga IKSH gjegjësisht të gjitha të dhënat e vendeve të marrjes së mostrave dhe evidentimi i tyre në hartën e rrjetave të ndara në zona të furnizimit dhe dërgimi i tyre me kohë në Prishtinë.

*Angazhim në marrjen e analizave për nevoja të KFOR-it Gjerman tre ditë rradhazi, për shkak të lajmërimit të turbiditetit në Bunarllëk II(defekti është evituar me kohë) si dhe është bërë pastrimi gjegjësisht shkarkimi i ujit në Bunarllëk II si dhe pastrimi dhe dezinfektimi i Rezervoarit të Kurillës(mbrenda në kazermë) nga ana e pjestarëve të KFOR-it Gjerman;

*Pjesëmarrja 2 ditore në Workshop(trajnim) e organizuar nga BE –TAIEX(Portugali),në Prishtinë për përpunimin dhe kontrollin e kualitetit të ujit ku kanë marrë pjesë të gjitha personat relevant që kanë të bëjnë me këtë lami nga tërë Kosova;

*Për shkak të mungesës së pjesëve reserve për kloraparate dhe lajmërimit të defektit në kloraparate në Bunarlluk i kemi vizituar Ujësjellësin e Batllavës-Prishtinë dhe kemi huazuar komplet kloraparatin(vacuum rregullatorin dhe rregullatorin për dozimin e sasisë së klorit). Kemi problem shumë gjatë instalimit të bombolave të klorit me çrast po lajmërohen ndytësirat që po shkaktojnë zaptime dhe më pas plasaritje të kloraparateve. Mu për këtë çështje kemi angazhuar KFOR-in Gjerman me paisjet e tyre të sofistikuar të na

ndihmnojnë në marrjen e analizave gjatë montimit të bombolave dhe për këtë na kanë dërguar analizat që I kanë bërë dhe çdo parametër që kanë bërë (ato që ne nuk mund të bëjmë) I janë përgjigjur standardeve të ujit të pijes. Si dhe kanë konstatuar se bombolat në fjalë gjatë montimit përbëjnë një sasi të konsiderueshme të ndytësirave dhe se procedurën para montimit të bombolës që I bëjmë ne kanë favorizuar shumë dhe se propozimi I tyre është që edhe në të ardhmen duhet të aplikojmë procedurën e njejtë për këtë destinim;

*Pjesëmarrja në mbledhjen e organizuar nga ana e SHUKOS-it në Prishtinë për menagjerët e cilësisë së ujit për të gjitha ujësjellsat Rajonal. Është diskutuar rreth çështjes së parametrave si Kimike ashtu edhe Bakteriologjike për të cilat bëhen matjet në laboratorët përkatëse gjegjësisht definimi I atyre parametrave që analizohen nga ana e ISHP-ëve si dhe definimi I çmimoreve për parametra gjegjëse pqr të cilat do të diskutojnë Kryeshefat Ekzekutiv në SHUKOS. Gjithashtu është bërë fjalë për akreditimet e laboratorëve në kuadër të Ujësjellsave Rajonal. Raporti për këto parametra që duhet të punohen i është dërguar z.Fidaim Jashari, Drejtorit Menagjues të SHUKOS-it si dhe Dr.Burbuqe Nushi, koordinatore për çështje të ujit në IKSH-Prishtinë;

*Analizat bakteriologjike të bëra nga ana e ISHP-së dhe nga ana jonë në disa pika të furnizimit janë përsëritur disa herë dhe se përqëndrimi kryesor I kontrollit ka qenë mu në këto pika. Është vija e furnizimit që përfshin Trgun e Gjelbërt, ShF.Abdyl Frashëri si dhe disa pika që ndërliken me këtë rrjetë!?

*Vizita e nje delegacioni nga ujësjellësi i Pejës për diskutim rreth çështjes së paisjeve për laborator dhe procesit të akreditimit;

*Vizita në rezervoarin e ri në Sallagrahdë dhe diskutim rreth mënyrës së vënjës së sistemit të klorifikimit me personin nga Prishtina i cili është autorizuar nga Kryshefi Ekzekutiv për instalimin e kloraprateve;

*Vizita dy ditore në fshatin Muradem për të rregulluar sitemin e klorifikimit për këtë fshat dhe për të bërë dezinfikimin e rrjetit. Për shkak se kurrë nuk është bërë klorifikimi dhe një kohë të gjatë është dashur të dezinfikohet rezervoari dhe rrjetat. Pasi që është bërë dezinfikimi janë marrë mostrat bakteriologjike para dhe pas dezinfikimit 2x. Klori residual ka rezultuar të jetë 0.3 mg/. Analizat bakteriologjike janë në rregull pas dezinfikimit;

*Pjesëmarrja në takim në zyret e Ministrisë me Menaxherin Teknik, Lulzim Paçarizi. Pjesëmarrës tjerë kanë qenë Këshilli Ndërmintor I Ujërave, IKSH, ZRRUK, SHUKOS dhe Menaxherët Teknik dhe Dhe Menaxherët e cilësisë së ujit të Ujësjellsave Regjinal për zbatimin e UA 16/20/12 për cilësinë e ujit të pijes. Agjenda e takimit ka qenë Zonat e Furnizimit, Monitorimi I Mbrendshëm, progresi në akreditimin e KRU-ve për monitorimin e cilësisë së ujit (Raport I SHUKOS-it). Jemi dakorduar që raportet për monitorim intern me kalkulime dhe sqarim si dhe hartën e zonave furnizuese të dërgohen Z.Afrim Lajç dhe Dr.Burbuqe Nushi. Këto komplet janë dërguar më vonë;

*Për shkak të rreshjeve të mëdhaja të gjitha burimet I kemi shkarkuar jashtë pasi që turbiditeti I ujit është rritur shumë. Kjo ka zgjatur një ditë pasi që të nesërmen uji është kthjelluar dhe i kemi futurë në system;

*Përcjellja e sistemit të furnizimit prej Buanlluk I dhe II për rezervoarin e Kurillës së bashku me ekipin e mirëmbajtjes për shkak të humbjes së klorit residual në këtë vi të furnizimit.

*Kemi vizituar disa herë Njësin e Malishevës për shkak të dyshimit se klori gjegjësisht Na-hipoklorit nuk është në rregull. Por, pas bisedimit edhe me furnitorin prej të cilit kemi kërkuar të na I dërgojë mostrën e klorit për analizë në laborator është konstatuar se klori është në gjendje të rregullt dhe I përgjigjet të gjitha parametrave për këtë llojë klori (në gjendje të lëngët). Për të bidur edhe menaxherin e Njësisë malishevë kemi vizituar dy herë malishevën dhe në vend kemi bindur ata se klori është në gjendje të rregullt dhe se duhet të përmbahen parametrave të parapara për bërjen e trejes dhe përcjelljes së klorit residual në të gjitha pikate e furnizimit në këtë Njësi;

*Marrja e mostrave në kroje të ndryshme me qëllim të monitorimit sa më të mirë të kualitetit të ujit ,ku gjatë kontrollimit të përhershëm që u bëjmë krojeve nëpër shkollë vërejtëm se në Shkollën Fillore „Abdyl Frashëri” në ortakoll kemi një situatë ku turbiditeti (turbullira) i ujit ishte më i madhë se normat që e lejojnë për ujë të pijes, andaj pas përsëritjes së mostrave disa ditore konstatuam se rrjeti I njërit objekt në këtë Shkollë ishte I dëmtuar dhe e bënte ndotjen e ujit . Ne njoftuam Drejtoreshën e shkollës për problemin dhe këshilluam që uji në këtë objekt nuk duhet të përdoret për pije deri sa të bëjnë ndrimin e gypave për mbrenda objektit. Deri në një vendim të tillë erdhëm pasi të tërë regjionin (lokalet e ndryshme) për rreth

shkollës e kontrolluam po ashtu edhe objektin tjetër në oborr të po të njëjtës shkollë ku uji ishte në suaza të normave të lejuara për konsum;

*Të gjitha shkollave u dërgua një njoftim që para se të filloj viti I ri shkollor puntorët ndihmës në këto shkolla të lëshojnë ujin që të rjedhë nga rubinetat e tyre me qëllim që të bëhet pastrami I tyre pasi nuk ka qarkulluar një kohë të gjatë;

*Vizitë në njësin e Malishevës me kërkesën e tyre për verifikimin e klorit të lëngët (hipoklorurin e natriumit) dhe verifikuam se çdo gjë me klorin ishte në rregull dhe se duhet që tiu përmbahen parametrave të parapara për bërjen e tretjes dhe përcjelljes së klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit në këtë njësi .

*Për shkak të rreshjeve të mëdha disa herë kemi vizituar 40 bunarët me ç'rast dy prej burimeve I kemi shakarkuar në lumë për shkak të ndotjes(kohëzgjatja e shkarkimit ka qenë 4-5 orë), 2x;

Në bazë të kërkesës së komitetit për hulumtime dhe zhvillim është bërë vizita në burimin Cvileni dhe janë marrur mostrat si dhe me z.G.Hoda është diskutuar rreth pikave që janë dhënë në mbledhjen e Kom. Për Hul. Dhe Zhvillim;

*Vizita në Prishtinë në IKSHP,DrBurbuqe Nushi për të diskutuar çështjen e analizave që nuk I përgjigjen stand.të ujit të pijes e që përbëjnë Cl-rezidual dhe është dorëzuar ankesa zyrtare në lidhje me këtë çështje;

*Vizita në Prishtinë me Lulzim Paqarizi për të diskutuar rreth analizave, që kanë qenë konteste, në zyret e ZRrUK-it ku u dakorduam të organizohet një mbledhje me përfaqsesit e IKSHP-Prishtinë, ISHP-Prizren dhe ZRrUK;

*Organizimi I mbledhjes në Prizren me përfaqses të IKSHP-Prishtinë, ISHP-Prizren, ZRrUK ku është diskutuar rreth analizave që nuk I përgjigjen standardeve të ujit të pijes e që përbëjnë klor residual në sasi të parapara për ujin e pijes;

*Marrja e mostrave dy ditore, me përfaqses në zyren e kryeminsitrit si dhe një përfaqses Belg, në vende të ndryshme në Prizren dhe Nashec.Marrja e mostrave kishte për qëllim verifikimin eventual të prezencës së materijeve radioactive në ujërat e ndryshme si dhe janë marrë mostra të dheut(është organizuar në tërë Kosovën) dhe dërgesa e mostrave në laboratorin e Belgjikës;

*Me kërkesë të stafit të Njësisë Dragash kemi vizituar këtë Njësi dhe kemi bërë raport për gjendjen aktuale të procesit të klorifikimit(raporti është dorëzuar). Përsëri kemi vizituar Dragashin për të riparuar dozatorin e klorit dhe për ta aktivizuar.

*Për shkak të rreshjeve të mëdha kemi larguar ujërat në 40 Bunarë(turbiditeti I lartë I ujërave). Koha e largimit dhe të futjes përsëri në system ujërat ka zgjatur rreth 6-7 orë;

*Vizita në rezervoarin e Baçevcit.Janë marrur mostrat dhe është bërë raporti për gjendjen aktuale për burimet mbi rezervoar;

*Vizita në burimin-Vërmicë për të bërë inçizimin për vendosjen e dozatorëve për klorifikim për sistemet Vërmicë,Dobrusht,Shkozë dhe Zhur;

*Mbledhja e Menaxherëve për cilësi të ujit të KRU –ve të Kosovës në zyret e Qeverisë gjegjësisht në Zyrën Ndërminstrore për Ujëra, z Afrim Lajçi dhe IKSHP, Dr.Burbuqe Nushi. Mbledhja është mbajtur për senzibilizimin dhe zbatimin e Udhëzimit Administrativ 12/2012 për cilësi të ujit me ç'rast është potencuar dorëzimi i dokumenteve të kërkuara nga KRU-të për të kompletuar monitorimin për cilësi të ujit (të gjitha dokumentet e kërkuara nga Institucionet e lartëpërmendura nga ana e KRU”Hidroregjioni Jugor “ janë dorëzuar me kohë), për dallim nga të tjerët që kanë dorëzuar parcijalisht ose fare nuk kanë dorëzuar. Konkluzionet e mbledhjeës JU kanë dërguar në mënyrë elektronike.

*Në marrëveshje me ISHP-Prizren për marrjen e mostrave në fshatrat që do të menagjohen nga ana e KRU”Hidroregjioni Jugor” ku edhe ne asistojmë, paralel me ISHP-në edhe ne do të marrim mostrat për analiza.

JANAR-DHJETOR- 2014

Muaji	Nr. Total	Bakteriologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.
JANAR	151	108	80	28	43	42	1
SHKURT	124	87	67	20	37	37	0
MARS	147	103	100	3	44	44	0
PRILL	165	122	89	33	43	43	0
MAJ	136	94	81	13	42	40	2
QERSHOR	141	99	90	9	42	42	0
KORRIK	143	98	91	7	45	45	0
GUSHT	135	95	91	4	40	40	0
SHTATOR	158	113	97	16	45	45	0
TETOR	149	104	99	5	45	45	0
NENTOR	131	87	87	0	44	44	0
DHJETOR	132	92	89	3	40	40	0
TOTAL	1712	1202	1061	141	510	507	3
% e Deshtimeve				11.7			0.6
% e Desht. Total							8.4

2.2.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

1. AKTIVITETET GJATË 2014

- Në fund të vitit 2014 në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 41,157 fatura, prej tyre: 35.658 amvisëri , 4.873 biznese dhe 626 institucione. Në fund të vitit 2014 në krahasim me vitin 2013 kemi 2279 fatura të lëshuara me tepër.
- Gjatë vitit 2014 janë faturuar 7,180,809 m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 5,941,946 m³, biznese: 487,779 m³ dhe institucione 524,824 m³ ujë. Nëse e krahasojm me vitin paraprak kemi një faturim më të vogël prej 487,779 m³.

Arsye kryesore për faturim më të vogël se 2013 janë:

- Në secilën njësi janë dhënë arsyet për performancën e faturimit , ndërsa në vazhdim keni arsyet kryesore për faturimin më të vogël në njësin e Prizrenit;
- Në vitin 2014 nuk është faturu Mamusha dhe Landovica me rreth 650 konsumatorë, harxhimi mesatar mujor te këto dy fshatra në periudhën kur është faturuar ka qenë rreth 4000- 4500m³ ujë , harxhimi vjetor sillet rreth 50,000m³ që nuk ka pas mundësi të faturohet në 2014 , pasi nuk i kemi furnizuar me ujë të pijes. Edhe pse ky numër i konsumatorëve ka qenë në bazën e konsumatorëve si numër, harxhimi i ujit ka qenë zero.

- Te disa biznese dhe instucioneve kemi harxhim më të vogël të ujit si rezultat i shfrytëzimit nga puset, eliminim i defekteve nëntokësore të cilët kanë rezultu me harxhim enorm. Në tabelën vijuese gjeni disa nga konsumatorët tek të cilët ka rënie në konsum të ujit:

Emri i Konsumatorit	Harxhimi 2013 (m ³)	Harxhimi 2014 (m ³)	Diferenca (m ³)
Shkolla Teknike "11 marsi"	5,624	0	-5,624
Hotel Theranda	1,784	5	-1,779
Hotel Theranda	1,083	39	-1,044
Abi Elif	3,050	2,630	-420
Abi Elif	46,162	2,443	-43,719
Qendra sportive	1,123	26	-1,097
Qendra sportive	3,078	2,629	-449
Spitali Daut Mustafa	15,189	3,834	-11,355
Spitali Daut Mustafa	94,765	12,191	-82,574
Spitali Daut Mustafa	33,650	27,353	-6,297
Spitali Daut Mustafa	26,193	12,564	-13,629
	231,701	63,714	-167,987

- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a. Gjatë këtij viti në nivel rajonal nga ekipet e kontrollës janë vizitu 16,146 konsumatorë, janë regjistru 2,041 konsumatorë të cilët bazuar në procedurat e mbrendshme janë legalizuar konsumatorët ilegal. Janë inkasuar 198,325.08 € euro nga konsumatorët të cilët kanë borxhe mbi 200 euro.
- Gjate vitit 2015 janë pranuar 1,271 ankesa ne total, prej tyre 764 ankesa teknike dhe 507 ankesa komerciale. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar në pajtim me procedurat e mbrendshme te Kompanisë.

2. PROBLEMET QË KANE NDIKUAR NE MOSARRITJEN E CAQEVE

Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :

- Rënie ne faturim si rezultat i rënies së konsumit të disa nga konsumatorët më të mëdhenj në tabelën e mësipërme.
- Te konsumatorët e amvisërisë - gjendja e rënde ekonomike . Shërbimi me Konsumatorë në secilën njësi është duke i evidentuar rastet të cilët janë nën përkujdesje sociale dhe pastaj ti drejtohem i Qeverisë apo Ministrive përkatëse lidhur me pagesën e këtyre obligimeve. Mbrenda muajit paraqiten 10-15 raste , të cilët janë raste me vështirësi ekonomike tek të cilët edhe nuk mund të bëjm shkyqjen nga rrjeti i ujësjellsit.
- Te bizneset , pamundësia e pagesave rrjedhese e cila vjen nga rënia e punës në biznese. Faktor tjetër është ndërrimi i shfrytëzuesve të pronës nga një qeraxhi tek tjetri dhe obligimet rrjedhëse trashegohen nga njëri te tjetri.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojn në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit: Dardania, dhe një pjesë e Bazhdarhanes.
- Një ekip i kontrollës ka mungesë e një automjeti dhe si rezultat i mungesës së këtij automjeti ankesat dhe kërkesat komerciale e konsumatorëve si dhe kontrollet rutinore ditore bëhen në këmbë dhe paraqet vështirësi në realizimin më kohë të punëve të përditshme.
- Borxhet e trashëguara si rezultat i ndarjes së trashëgimisë (nga babai te vëllezrit), shitblerjet e pronave të cilat kanë trashëgu borxhe, pronat e shfrytëzuara në mnëyrë të paligjshme etj.

3. MASAT E REALIZUARA/ MOSREALIZUARA NGA VITI PARAPRAK

- Rritje në numrin e konsumatorëve në zonën e shërbimit për 2,279 konsumatorë
- Rënie e inkasimit nga uji në krahasim për vitin paraprak për rreth 48.000 euro, është rënie kryesisht në amvisëri si rezultat i pamundësisë së pagesës së konsumatorëve të amvisris. Gjithashtu ulja e shpenzimeve të ujit të bizneset dhe institucionet e lartëcekura ka pamundësu inkasimin e rregullt kryesisht nga këto institucione dhe biznese.
- Është hap edhe një pikë për pagesa në objektin e Komunës së Prizrenit.
- Janë vizituar 16,146 konsumatorë tek të cilët është bërë vizit rutinore për lexim të ujëmatësve, keqpërdorime eventuale të ujit etj
- Gjatë vitit 2015 janë nënshkruar 557 kontrata me konsumatorë për riprogramim të borxhit në afat dy dhe trevjeçar, fillimisht në njësin e Prizrenit dhe më pas të vazhdoj edhe në njësit tjera. Vlera monetare e kontraktuar është rreth 240.788.69 euro, vetëm në njësin e Prizrenit. Efektet janë të shumëfishta nga nënshkrimi i kontratave : së pari konsumatori pranon borxhin dhe e dyta në rast të mospërbushjes së detyrimeve të kontraktuara , konsumatori mund të paditet në gjykat.
- Janë shkyq 121 konsumatorë për lidhje jashtë orës, të cilët janë konstatu që kanë shfrytëzuar ujin në mënyrë të paligjshme dhe 18 konsumatorë tjerë për mospagesë të borxhit
- Kontrolla në nivel rajonal gjatë vitit 2014 , nga konsumatorët të cilët kanë borxh mbi 300 euro ka inkasuar 198,325.08 €.

4. MASAT E PROPOZUARA PËR VITIN E ARDHSHËM

- Shtimi i pikave për pagesë (arkave) për shërbime të ujëjellsit edhe në së paku dy lagje tjera mbrenda qytetit të Prizrenit dhe në njësit tjera operative
- Në bashkëpunim me menaxhmentin do të shiqohet mundësia e heqjes së pagesës tek inkasantët ku konsumatorit ti jepet mundësia të bëj pagesën në arkat e kompanisë ose në forma tjera si Kos-Giro .
- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit për së bashku me operativen për shkyqjen e konsumatorve borgjlinj të mëdhej mbi 300,00 euro, të cilët nuk bëjnë pagesa dhe riprogramim të borxhit, në secilin muaj ndërrohet terreni nga një inkasant tek tjetri.
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borgjeve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjeve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të fakturave. Secili inkasant në terren mund të bëjë kontrata për riprogramim të konsumatorët e terrenit të tij, te ata konsumatorë që kanë borxh mbi 200 euro. Për secilën kontratë të nënshkruar inkasantët do të stimulohen më një pagesë prej 5 eurove.
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pages nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .Te këto raste nuk do të bëhet rikyqja pa u bërë një pjesë e pagesës dhe të nënshkruhet kontrata për riprogramim të borxheve.
- Marrja e masave ligjore sipas Zyres Rregullative për shkyqjen e konsumatorve për mos pages. Secili konsumatorë para shkyqjes duhet të njoftohet bazuar në procedurat ligjore nga Zyra Rregullative.
- Rritja e efikasitetit të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
- Inicimi i padive të konsumatorëve në gjykatë për mos pagesë.Tek rastet ku nuk ka mundësi teknike të shkyqjes ato raste do të inicohen në gjykatë për zgjidhjen e problemit të borxhit.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjeve aty ku kanë vështirsi inkasantet.Në secilin muaj do të caktohet një terren dhe kontrolla do të merret me konsumatorët që nuk paguajn borxhet .

2.2.2 RAPORTIMI EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	1144	62	57	9696	179,421.84 €
2	Suharekë	969	174	129	3772	32,082.84 €
3	Malishevë	131	72	67	2052	18,510.92 €
4	Dragash	17	2	1	101	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	2261	310	254	15621	230,015.60 €

2.2.3 RAPORTI I ANKESAVE

MUAJI	JAN	SHKU	MAR	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJET	TOTAL
ANK. TEK.	76	55	52	73	68	65	68	90	65	58	45	48	763
TË SHQ.	76	55	50	73	68	65	68	90	65	58	45	48	761
ANK. KOM.	47	40	55	30	48	34	42	25	53	44	30	59	507
TË SHQ.	47	40	52	30	48	34	42	25	53	44	30	59	504
TOTAL	123	95	107	103	116	99	110	115	118	102	75	107	1.270

Koment:

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me kohë. Konsumatorët kanë marrë përgjigje zyrtare nga kompania.

Një numër i konsideruar i ankesave është konstatuar se kanë qenë të babazuara.

2.2.4 RAPORTI I MEDIAVE

Zyra për marrëdhënie me publikun, është munduar që nga fillimi i vitit 2014, që përcjelljen e porosisë që del nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a., përmes mediave elektronike dhe të shkruara, ta bartë te opinionin publik, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të ndershme, njëkohësisht duke mbrojtur interesat e Kompanisë në përgjithësi dhe konsumatorit në veçanti.

Mediat lokale, i kanë kushtuar hapësirë të mjaftueshme KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. Kanë dhënë kontribut të madh në mënyrë indirekte dhe direkte në ngritjen e shkallës së arkëtimit, në vetëdijësimin e qytetarëve, se uji që shpenzohet duhet kursyer dhe duhet paguar, në informimin e qytetarëve se ujësjellësi i Prizrenit është duke punuar në atë drejtim që t'i përmirësojë shërbimet e veta ndaj çdo konsumatori, se kjo kompani me përkushtimin e saj më të madh, ka arritur që të përfitojë donacione të mëdha nga investitorët e huaj dhe Qeveria e Kosovës, vetëm e vetëm që konsumatorëve të saj t'u ofrojë shërbime sa më cilësore.

Edhe mediat e shkruara kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. dhe se hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

RAPORT PËR MEDIA

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2014

PËRSHKRIMI	NUMRI TOTAL
Njoftime ne TV, Radion dhe Shtypin ditorë	27
Intervista ne TV dhe Radio	13
Emisione ne TV dhe Radio	8
Perurime- Tv lokale dhe Qendrore	2
Shpallje t konkurseve ne shtypin ditor	17
Artikuj ne shtypin ditor	34
Artikuj ne shtypin elektronik	61
Prezantimi i ligjëratave para nxeneseve- ujerat e zeza	1
Debat publik me qytetare	1

KONKLuzion

KRU-“Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren, gjatë vitit 2014, ka dërguar njoftime, në mediat elektronike dhe të shkruara, lidhur me aktivitetet që po ndërmerr kjo kompani, filluar nga furnizimi me ujë të pijshëm, aplikimi i shkyçjeve, qoftë kolektive apo individuale , e deri te cilësia e ujit që konsumatorët e marrin në krojet e tyre. Disa nga njoftimet janë emetuar në televizione, e disa janë publikuar si shkrime në shtypin ditor, duke dhënë çdo herë një mesazh për opinionin publik.

Mediat janë kan publikuar informacioneve te opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-Hidroregjioni Jugor dhe hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë kontribuar edhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit në KRU-Hidroregjioni Jugor, duke plasuar informacione të shumta në publik, lidhur me aktivitetin e shkyçjeve të konsumatorëve borxhlinjë.

Të gjithë artikujt e gazetave ditore dhe të gjitha intervistat, emisionet e drejtpërdrejta në televizione dhe radio, janë të ruajtura në arkivën e zyrës për marrëdhënie me publikun.

2.3.1 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament, departamenti i administrates mirret me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik.

- Gjatë këtij viti janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.

- Pas përgaditjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe të komiteteve janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me konkluzionet apo raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për skadim e kohëzgjatjes së kontratave të punës të Zyrtarëve të lartë të Kompanisë-Kryeshefit Ekzekutiv dhe Auditorit të Brendshëm të cilat me pastaj janë vazhduar, nga Komisioni i Auditimit (për AB) dhe Bordi i Drejtorëve (për KE).
- Janë përgaditur dhe vazhduar kontratat e punës së punonjësve që kanë qenë në kohë të caktuar prej 6 muajve dhe kontratat e punës për vitin 2015, për të gjithë punëtorët e Kompanisë. Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Janë përtrirë Marrëveshjet e Shërbimit për shërbimet e ujësjellësit dhe ujrave të zeza me Komunën e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit. Pas skadimit të afatit fillestar janë vazhduar edhe për katër (4) vjet të tjera.
- Është vazhduar të punohet në regjistrimin e punëtorëve në librin amëz sipas datës së fillimit të punës në Kompani.
- Është përseritur prap urdhëresa (e dhjetorit 2013) për ndermarrjen e hapave për preventivë dhe siguri të objekteve e njesive operuese, e cila është drejtuar udhëheqësve të njesive punuese pranë KRU "Hidroregjini Jugor" Prizren.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Janë përgaditur Vendimeve për mbikqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njesive punuese.
- Përgaditja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgaditja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marëdhënieve të punës.
- Një punëtor i njesisë së Suharekës është lënduar në vendin e tij të punës dhe në përputhje të nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurin dhe Shendetin në punë punonjësit I është bërë pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2014 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjetëve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servisën e bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, portoarkën, kërkuarit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2014 gjërë më 15.01.2015 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpilojë raport mbi kryerjen e të njejtës dhe t'ia dorëzojë Kryeshefit Ekzekutiv gjërë më 20.01.2015.
- Në përputhje me nenin 95 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr. 03/L-212, dhe nenit 7, alineja 2 e Statutit të Kompanisë, Bordi i drejtorëve ka aprovuar njëzëri "Rregulloren mbi Përgjegjësin Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. – Prizren.
- Janë përpiluar dispozita të përgjithshme lidhur me detyrat dhe obligimet e rojtarëve nëpër objektet e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a, ndër të tjera përfshihen edhe formulari i procesverbalit gjatë pranim-dorëzimit të ndërrimit dhe formulari i procesverbalit nëse ka ndodhur ndonjë defekt në objekt.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 16 konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë, një konkurs është anuluar për mos plotësim të kriterëve nga kandidatët aplikues për konkurset përkatës. Pas mbylljes së konkursit përkatës më vendim është caktuar

komisioni i cili shqyrton aplikacionet e aplikantëve, përgadit listen e ngusht të kandidatëve, kryen testin me shkrim dhe intervisten si dhe bënë zgjedhjen e kandidatit.

- Në Department të Administratës kemi patur auditim nga Auditori i Jashtëm “Kanuni i Auditorit” për vitin 2013 .
- Takim konsultativ-punës në NJPMNP me temë: Komunikimi në mes të NP dhe NJPMNP dhe Arkivimi i dokumentacionit të QK të vitit 2013.
- Është përgaditur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2013 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : qertifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi emrimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2013, vendimet e Bordit për 2013, procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Vendimet mbi themelimin e komitetëve tjera të Bordit , procesverbalet e komiteteve, plan-biznesi 2013-2015 dhe raporti vjetor 2013.
- Përgjigje çdo tre muaji NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike nga asnjë profil i aplikuesve dhe se ne të ardhmen nëse paraqiten kërkesa të tilla do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Është dërguar e plotësuar në NJPMNP sipas kërkesës së tyre, lista me të dhenat për të punësuarit me aftësi të kufizuar (në Kompani rasti është Invalid I luftës së UÇK-së). Poashtu në NJPMNP është dërguar lista me nr. e të punësuarve sipas nacionaliteteve për vitin 2013.
- Nga NJPMNP kemi njoftuar që është kërkuar nga Zyra ligjore e Kryeministrit interpretimi i Vendimit mbi Kompenzimin e Bordit dhe deri në pranimin e interpretimit nga ZLK është kërkuar që asnjë komitet i përkohëshëm të mos kompenzohet.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista e udhetimeve zyrtare të punonjësve të KRU "Hidroregjioni Jugor" gjatë vitit 2013 si dhe lista me sqarimin e dhënë nga shërbimi financiar lidhur me sponzorimet dhe donacionet nga KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren.
- Pjesëmarrja në grupin punësor në SHUKOS për rishikimin dhe ndryshimin e Statutit të SHUKOS-it.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, Menaxhimit të Projektëve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Me Vendim është Emruar përfaqësuesi brenda kompanisë për mbarëvajtjen e projektit "Programi mbështetës për uji dhe kanalizim në zonat rurale faza e V-të". Përfaqësuesi i Emruar nga KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A do të bëjë Sigurimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe shkëmbimi i tyre në mes të CDI , Kuvendeve Komunale dhe institucioneve tjera të involvuara në projekt. Organizimin e vizitave në terren me qëllim të vërtetimit të informacioneve sa i përket gjendejes ekzistuese të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve , njëherit identifikimi i pozicioneve për ndertimet e parapara në studimin e fizibilitetit.
- Është përgaditur Kontratë mbi dhenjen e shërbimit, ndërmjet K.U.R. "Hidroregjioni jugor" Sh.A dhe K.R.U. "Radoniqi" Sh.A. me seli në Gjakovë. Lënda e kësaj kontrate është riparimi dhe servisimi i ujmatësave në servis për riparim dhe servisim të ujmatësave (Bazhdarim) në Prizren, me profile të ndryshme nga ana e K.R.U. "Hidroregjioni jugor" Sh.A. si dhënësi e shërbimit. Shfrytëzuesi i shërbimit obligohet që në emer të riparimit dhe servisimit të ujmatësave të paguaj sipas Vendimit mbi caktimin e çmimorës e cila është pjesë përberse e kontratës, dhe pagesën në emer të TVSH-së.
- Janë shpërblyer për angazhim të veçant në punë, 10(dhjetë) punëtorët e dalluar për vitin 2013 me mjete monetare në vlerë prej 100 € dhe me mirënjohje.
- Në Department të Administratës kemi patur auditim nga Auditori i Brendshëm lidhur me ndryshimet apo rritjen e pagës bazë (koeficientëve) për punonjësit e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a në Prizren, për periudhën kohore janar – dhjetor 2013 dhe auditimi tjetër ishte me temë Menaxhimi i procesit të shqyrtimit të lëndëve gjyqësore në KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a për periudhën kohore janar-nëntor 2014.

- Për shkelje të detyrave të punës është shqiptuar masa disiplinore Ulje në pozitë për punonjës R.S të njësisë së Dragashit dhe dy Suspendime të punëtorëve në njësinë e Prizrenit.
- I është ndërprer kontrata e punës një punëtori në njësinë e Prizrenit(B.Sh)ngase nuk është lajmëruar disa ditë në vendin e tij të punës dhe nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë. Në njësinë e Malishevës për shkakë të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës punëtorit F.K I është ndërprerë kontrata e punës me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës .
- I është ndërprerë kontrata e punës një punëtori-inakasant në njësinë e Suahrekës(B.E) ngase nuk është lajmëruar disa ditë në vendin e tij të punës dhe nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë.Poashtu në njësinë e Suharekës një punëtori(L.S) me marrëveshje në mes të punësuarit-inkasant dhe Kompanisë i është ndërprerë kontrata e punës.
- I është ndërprer kontrata e punës një punëtori-rojtar në njësinë e Malishevës(F.J) ngase nuk është lajmëruar disa ditë në vendin e tij të punës dhe nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë.
- Mbështetur në Procedura për Mbikqyrje dhe Monitorim e NP Qendrore pika nent(9),është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për mungesën e Sekretarit të Kompanisë në punë (pushim vjetor)nga dt.07.07.2014 deri me 18.07.2014.
- Mbështetur në Procedura për Mbikqyrje dhe Monitorim e NP Qendrore pika nent(9),është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për mungesën e Zv.Kryeshefit Ekzekutiv në punë (pushim vjetor)nga dt.29.12.2014 deri me 16.01.2015.
- Është njoftuar Zv.Kryeshefi Ekzekutiv për takimin e Bordit te mbajtur me dt.26.06.2014 me ç’rast është diskutuar nga Bordi i Drejtoreve qështja e pjesmarrjes se Zv.Kryeshefit Ekzekutiv në takimet e Bordit dhe që është vendosur nga Bordi për pjesmarrjen e Zv.Kryeshefit Ekzekutiv në takimet e Bordit të Drejtorëve si vëzhgues apo pjesmarrës pa të drejt vote.
- Kemi pranuar nga zyra e Auditorit të Përgjithshem “Raportin e Auditimit për kompensimet e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për periudhen 2009-2012”
- Është realizuar takim pune me përfaqësuesin e Këshillit Ndërmintrosor për Ujëra, me temë të diskutimit:1.Arkëtimi i faturave/Sistemi i menaxhimit të borxheve,2.Uji i pa-faturuar/humbjet e ujit,si pas kërkesës së tyre në menyrë elektronike është plotësuar dhe dërguar pyetësori nga shërbimet e Kompanisë.
- Jemi njoftuar nga NJPMNP lidhur me përmbushjen e kërkesës ligjore nga Ligji mbi NP Nr. 03/L-087, neni 28 per Vlerësimin e Efektshmërisë së Bordit të Drejtorëve,me qrast MZHE ka kontraktuar një kompani konsulente e cila do te bej vlerësimin e Bordeve të Drejtoreve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore .
- Është bërë kordinimi i kohës së mbajtjes takimeve ndaras me secilin Drejtor te Bordit te Drejtoreve për vlerësim të efektshmërisë nga kompania konsulente“ Management Consulting Institute” e kontraktuar nga NJPMNP-MZHE që ta bëjë Vlerësimin e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore konform nenit 28 të Ligjit mbi NP. Dokumentet e kërkuara nga kompania konsulente“ Management Consulting Institute” për të bërë vlerësimin e efektshmërisë së Bordeve në KRU”HRJ” janë dërguar me CD dhe librin lidhës për “Qeverisje Korporative”te vitit 2013.
- Përmes ueb-faqes së Kompanisë janë njoftuar konsumatorët se nese nuk i përgjigjen detyrimit lidhur me pagesat për borxhin e krijuar në emër të shfrytëzimit të ujit të pijshem lëndët do të dërgohen për veprim të mëtutjeshëm te Përmbaruesi Privat ku konsumatorët do të jenë të ngarkuar me shpenzime shtesë.Poashtu përmes ueb-faqes janë njoftuar konsumatorët se sipas Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës kyqjet ilegale dhe keqpërdorimet në rrjetin e ujësjellesit konsiderohen Veper Penale.Eshtë bërë publikimi në ueb-faqe i raporteve tremujore të Kompanisë për 2014 dhe Planë-biznesit të Kompanisë 2015-2017.
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përkatësishtë Agjencia e Metrologjisë së Kosovës me Vendim Autorizon KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh.A në Prizren,që mund të bëjë përgaditjen e ujëmatësve për verifikim dhe atë ujëmatësat me diametër nominal prej DN13 deri DN40.

- Me kërkesë të NJPMNP është përcjellur njoftimi lidhur me datën e fillimit dhe skadimit të kontratave të punës për Zyrtarët e lartë të Kompanisë.

2.3.2 PERSONELI

PERSONELI – JANAR – DHJETOR 2014 (nuk është numruar Bordi)

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Janar	292	1	0	1	27.01.vdes punt.D.Ç
Shkurt	296	4	0	0	
Mars	302	6	0	0	2 punt.pushim pa pages
Prill	303	1	1	0	
Maj	302	0	1	0	
Qershor	304	2	0	1	
Korrik	302	0	2	0	
Gusht	300	0	2	0	1 punt.push.pa pages
Shtator	300	2	0	0	2 punt.push.pa pages
Tetorë	299	0	1	0	1 punt.push.pa pages
Nentor	300	1	0	0	1 punt.push.pa pages
Dhjetor	304	4	0	0	2 punt.push.pa pages

PERSONELI ,BORDI DHE NJESITË PUNUESE JANAR-DHJETOR-2014

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Total			
1	Janar	297	212	5	217	34	18	28
2	Shkurt	301	213	5	218	35	19	29
3	Mars	307	214	5	219	38	21	29
4	Prill	308	215	5	220	38	21	29
5	Maj	307	216	5	221	37	21	28
6	Qershor	309	219	5	224	37	20	28
7	Korrik	307	218	5	223	36	20	28
8	Gusht	305	218	5	223	34	20	28
9	Shtator	305	216	5	221	35	20	29
10	Tetor	304	216	5	221	34	20	29
11	Nëntor	305	216	5	221	34	20	30
12	Dhjetor	309	219	5	224	34	20	31

2.3.3 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	251	36	6	11	304
Numri i Punëtorëve në %	82.6	11.8	2.0	3.6	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	33	10.86	
MESHKUJ:	271	89.14	
TOTAL	304		

2.3.4 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A							
KUALIFIKIMI							
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Shk. e mesme	Kualif. profesional	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	30	23	193	1	52	5	304
Kualifikimi në %	9.87	7.57	63.49	0.33	17.11	1.64	

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndaj konsumatorëve, respektivisht mirëmbajtjes së rrjetit kompania ka paraparë që të rrisë numrin e punëtorëve gjatë vitit 2014 varësisht nga numri i fshatrave që do të merren në menaxhim.

Numri i punëtorëve në Plan-Biznes 2014-2016 është planifikuar duke u marrë parasysh: Vendet e reja të punës të parapara në organogram, ndryshimet në staf, propozimet e reja për rritje të kontrollës në tren, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, rritja e numrit të konsumatorëve si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani.

Arsyeshmeria i rritjes së numrit të punëtorëve në vitin 2014 është se parashihej një menaxhim dhe një mbikëqyrje e punimeve në nivel profesional dhe se Kompania ka pasur nevojë për kuadro profesionale. Pra rritja e planifikuar e numrit të personelit është bërë duke u bazuar në planifikimet e udhëheqësve të njësive operative të Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.

2.3.6 RAPORT I ZYRES LIGJORE LIDHUR ME PUNËT E KRYERA NË JANAR – DHJETOR 2014

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për Ekzekutim	Kallëzime Penale	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Deklarata në Prokurori	Parashtrësia në Gjykata	Parashtrësia në Prokurori	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtrë nga Kompania	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtrë nga	Përgjigje në Ankesat e Parashtrë nga në Gjykatën e	Kundërshtimet nga	REVISION	TOTALI	Totali i lëndëve të archura nga Gjykatat
JANAR	/	/	1	/	1	4	1	/	3	/	/	/	/	/	/	10	10
SHKURT	3	1	6	/	1	4	1	/	/	/	/	/	/	/	/	16	8
MARS	/	/	4	2	1	2	3	1	1	2	2	/	/	2	/	20	12
PRILL	1	1	/	1	/	2	5	/	3	/	/	/	/	/	/	12	15
MAJ	/	/	/	/	/	1	2	/	/	/	/	/	/	/	/	3	10
QERSHOR	/	/	/	/	/	2	3	/	/	/	/	/	/	/	/	5	8
KORRIK	/	1	/	/	1	1	1	/	2	/	1	/	/	1	/	8	11
GUSHT	/	/	1	/	1	1	/	/	1	/	1	/	/	/	/	5	3
SHTATOR	/	/	9	2	2	2	2	/	1	/	/	/	/	/	/	18	5
TETOR	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	3	/	3	7
NËNTOR	/	/	/	1	/	/	/	/	/	/	/	1	1	/	/	3	9
DHJETOR	/	/	/	3	/	1	/	/	5	/	/	/	/	/	/	9	10
Totali	4	3	21	9	7	20	18	1	16	2	4	1	1	6	/	112	108

PARASHTRËSA

- Është bërë parashtrësë për KK Prizren lidhur me interesimin tonë se në pronësi të kujt janë 2 (dy) galeri afër objektit të Kompanisë, pasi që këto galeri kanë qenë në shfrytëzim të ish ndërmarrjes “Cvileni”.
- Është bërë1 (një) parashtrësë në Policinë e Kosovës me kërkesën për vendin rreth objektit të vjetër në qendër të qytetit për ndalimin e qarkullimit dhe parkimit të mjeteve motorike në atë vend pasi që lehtë mundet me pësuar uji i pijes me ndotje nga automjetet që qarkullojnë dhe parkohen në atë hapësirë.
- Është bërë1 (një) parashtrësë në Inspektoratet Komunale të KK Prizren, me kërkesën për vendin rreth objektit të vjetër në qendër të qytetit për ndalimin e qarkullimit dhe parkimit të mjeteve motorike në atë vend pasi që lehtë mundet me pësuar uji i pijes me ndotje nga automjetet që qarkullojnë dhe parkohen në atë hapësirë.

- Është përkthyer Përgjigjen ndaj një ish punonjësi të Kompanisë i nacionalitetit Serb, lidhur me Kërkesën e të njëjtit për blerjen e banesës të cilën e kishte pasur në shfrytëzim nga Kompania jonë, dhe të njëjtën e kemi dorëzuar në Postë.
- Pranë Gjykatës Themelore Dega në Suharekë me Parashtresë kemi kërkuar informatë se përse ende nuk është ekzekutuar lënda **CP .nr. 11/13**, ku kemi marrë përgjigje se duhet që pranë kësaj Gjykate ta dërgojmë numrin e Xhirologarisë së Debitorit.
- Parashtresë për **Prokurorinë Themelore në Prizren** me të cilën ne e njoftojmë këtë Prokurori se sa i përket Kallëzimit Penal të parashtruar pranë kësaj Prokurorie, për Kompaninë tonë kjo çështje ka përfunduar pasi që ne e kemi realizuar kërkesën tonë pasurore juridike.
- Përgjigje në Ankesë lidhur me Ankesën e parashtruar nga marrëdhënia e punës.
- Në Gjykatën Themelore të Prizrenit , Parashtresë me kërkesën që të na shtyhet afati për gjetjen e adresave të Debitorëve për borxhe ndaj Kompanisë sonë, pasi që me Konkluzionet e Gjykatës na është urdhëruar që në afat prej 3 (tri) dite.
- Janë bërë 2 (dy) parashtresa për Gjykatën Themelore në Prizren lidhur me shtyrjen e dy Seancave të parapara për me 11.04.2014.
- Me datë 18.04.2014 e kemi shkruar një Parashtresë për Gjykatën Themelore në Prizren me kërkesën që të na jepet materiali i plotë lidhur me Padinë **C. nr. 1078/13** e parashtruar nga z. Enver Vila pasi që në shkresat e lëndës nuk ishin Provat e parashtruara nga Padiësi.
- Për parcelen e paditësit Kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit në Prizren lidhur me Padinë kunder Kompanisë **C. nr. 1078/13**.
- Parashtresë për Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Dragash, me ç`rast kemi kërkuar fotokopjet e Provave nga lënda e Aktgjykimit, P. nr. 116/03, datë 08.05.2013, pasi që Padija ka ardhur pa asnjë nga Provat e parashtruara të paditësit.
- Sot me datë 08.09.2014, e kemi përpiluar dhe dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren Parashtresë për caktimin e përfaqësuesit të Përkohshëm.
- KEDS-it Njoftim lidhur me dëmet e shkaktuara Kompanisë si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike me kërkesë për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj Kompanisë sonë në lartësi prej 20.142.23 € (Njëzetë mijë e njëqindtë e dyzet e dy Euro e tridhjetë e tre cent) në afat prej 10 (dhjetë) ditësh.
- Njoftim drejtuar Zyrtarit të Lartë Financiar lidhur me nevojat e Kompanisë për Aparatet për Fikjen e zjarrit.
- Kërkesë për angazhimin e Përmbauesit Privat nga Prishtina për kryerjen e lëndëve të Kompanisë .
- Vendim lidhur me masën e shqiptuar Vërejtje me gojë Udhëheqësit të Njesisë Punuese në Dragash z. Elsadat Rysheni.
- Marrëveshje për pagesën e dëmit të shkaktuar Kompanisë nga ana e Udhëheqësit të Njesisë Punuese në Dragash me të cilën parashihet kthimi i Dëmit të shkaktuar ndaj Kompanisë në vlerë prej 98.05. Eurove.
- Njoftim për Zyrën e Financave lidhur me Marrëveshjen Kolektive e cila fillon të implementohet nga data 01.01.2015.

PADI KUNDËR KOMPANISË

- Është pranuar nga Gjykata Themelore në Prizren dorëzoi Padi, C. nr. 301/13, me të cilën Padiësi kërkon kthim në vendin e tij të punës ku ne detyrohemi që në afat prej 15 ditësh të japim Përgjigje në Padi.
- Gjykata Themelore në Prizren Thirrje për pjesë në seancë gjyqësore ndaj Kreditorit Kompensim dëmi, për këtë Padi Gjykata nuk na ka obliguar që të japim Përgjigje në Padi por vetëm Thirrje për seancë gjyqësore.

- Gjykata Themelore në Prizren thirrje për shqyrtimin kryesorë lidhur me lëndën P. nr. 304/13, në seancë gjyqësore ndaj Paditësit në cilësinë e dëshmitarit. Për këtë Padi Gjykata nuk na ka obliguar që të japim Përgjigje në Padi por vetëm Thirrje për seancë gjyqësore.
- Gjykata Themelore në Prizren Padi, C. nr. 1078/13, datë 17.04.2014, me të cilën paditësi kërkon Dëmshpërbllim në vlerë prej 24.000,00 € me kamatë nga data e ngritjes së kësaj Padie në Gjykatë nën pretekstin se Kompania ia ka dëmtuar një sipërfaqe toke prej 0.3 ari.
- Gjykata Themelore në Prizren dorëzoi Padi , Lënda C. nr. 391/12, datë 20.06.2014, me të cilën paditësi kërkon Dëmshpërbllim në vlerë prej 15.000 € për shkak të dëmeve të shkaktuara në shtëpinë e tij nga plasja e gypit të ujit të pijshëm.

PËRGJIGJE NË PADI

- Është dërguar Gjykatën Themelore në Prizren Përgjigje në Padi-në e Lëndës C. nr. 301/13.
- Është dërguar Gjykatën Themelore në Prizren Përgjigje në Padi-në Lëndës C. nr. 1078/14, datë 17.04.2014.
- Është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren Përgjigje në Padi-në ndaj Padi së ardhur me datë 23.06.2014, lidhur me Lëndën e evidentuar me C. nr. 391/12, datë 20.06.2014.

KËRKESË PËR PRECIZIM TË PROPOZIMIT PËR EKZEKUTIM

- Nga Gjykata e Themelore në Prizren kemi pranuar Aktvendim, Cp. nr. 1494/13, datë 02.09.2013, sipas të cilit kërkohet nga Kompania jonë që në këtë Gjykatë të dërgohet Precizim i Propozimit për ekzekutim, nën kërcënimin se mos-përmbushja e kërkesës sipas këtij Aktvendimi kjo Gjykatë do të merr vendim me të cilin do ta hedh poshtë si jo të plotë Propozimin për ekzekutim.

PRECIZIM I PROPOZIMIT PËR EKZEKUTIM

- Është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren Parashtresë me të cilën bëhet Precizimi i propozimit për ekzekutim të Aktvendimit Cp. nr. 1494/13, date 19.06.2014 ndaj Debitorit.

ANKESA NË GJYKATËN E APELIT NGA KRU

- Është dërguar Ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kundër Aktvendimit E. nr. 684/2007, datë 12.03.2014 të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren me të cilin është përmblyer Propozimi për Ekzekutim nga Debitori pasi që i njëjti e ka bërë pagesën borxhit të krijuar pas Propozimit për Ekzekutim, ndërsa borxhin nga Padi në lartësi prej 323.57 € e ka të paguar.
- Është dërguar Ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, lidhur me Aktgjykimin C. nr. 772/11, datë 05.02.2014 të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren me të cilin është kërkuar nga Debitori që nga borxhi i gjithmbarshëm të paguaj shumën prej vetëm 56,06 € (nga totali prej 1.209,32 €).
- 3. Me datë 17.03.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Ankesë e Prokurorit të Shtetit (PSH) drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë kundër Aktgjykimit P. nr. 329/13, datë 10.02.2014, me të cilën kërkon që të njëjtin ta prishë, dhe të njëjtin ta kthej në rigjykim ose ta ndryshojë, në mënyrë që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe t'ia shqiptoj dënimin në kufi të lejuar ligjor.
- Është dhënë Ankesë ndaj Aktgjykimit P. nr. 116/03, datë 08.05.2013 dhe Plotësim Ankese lidhur me Lëndën C. nr. 116/03.

ANKESA NË GJYKATËN E APELIT KUNDËR KRU-së

- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Ankesë, kundër Ankesës së Prokurorit të Shtetit lidhur me lëndën PP. nr. 277/2012, datë 14.03.2014.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Ankesë, ndaj Aktgjykimi C. nr. 301/13, datë 29.09.2013, nga marrëdhënia e punës me të cilin e sulmon në tërësi Aktgjykimin e marrë nga Gjykata Themelore në Prizren.

PËRGJIGJE NË ANKESA

- Është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren për Gjykatën e Apelit në Prishtinë Përgjigje në Ankesë, ndaj Ankesës së Paditësit për kthim në vendin e punës të parashtuar kundër Aktgjykimit C. nr. 301/13, datë 29.09.2013, të Gjykatës Themelore në Prizren.

VENDIMET E GJYKATËS THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË

- Me datë 17.01.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim lidhur me lëndën C. nr. 354/08, datë 06.01.2014, me të cilin konsiderohet e tërhequr Padia e Paditësit kundër Kompanisë sonë pasi që Paditësi dhe as i Autorizuari i tij nuk kanë marrë pjesë në asnjë nga 2 (dy) seancat e thirrura rregullisht nga Gjykata Themelore.
- Me datë 23.01.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim lidhur me lëndën C. nr. 75/2009, datë 21.01.2014, me të cilin konsiderohet e tërhequr Padia Kompanisë për shkak të Përrjashtimit nga Ekzekutimi.
- Me datë 28.01.2014, në seancën gjyqësore lidhur me lëndën C. nr. 262/10, për Vërtetimin e Pronësisë, i Autorizuari i Paditësit me precizim të Padisë ka hequr dorë nga Padia ndaj Kompanisë dhe Qeverisë.
- Me datë 06.02.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim lidhur me lëndën C. nr. 628/10, datë 23.01.2014, me të cilin obligohet Debitori që ta paguaj Borxhin në lartësi prej 393,96 € së bashku me shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit.
- Me datë 24.02.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim lidhur me lëndën C. nr. 569/11, me të cilin konsiderohet se Padia e Paditësit ndaj Kompanisë është tërhequr, pasi që Paditësi nuk ka ardhur në seancën gjyqësore edhe pse i ftuar rregullisht.
- Me datë 28.02.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim lidhur me lëndën P. nr. 176/20013, datë 14.02.2014, me të cilin i Pandehuri është shpallur fajtorë dhe është dënuar me 6 (gjashtë) muaj burg të cilin Gjykata ia ka shëndrruar në Dënim me të holla.
- Me datë 11.03.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim lidhur me lëndën C. nr. 772/11, datë 05.02.2014, me të cilin obligohet Debitori që ta paguaj borxhin në lartësi prej 56,06 € (nga totali prej 1.209,32 €) së bashku me kamatë vjetore dhe shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit.
- Me datë 17.03.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim lidhur me lëndën P. nr. 349/2011, datë 25.02.2014, me të cilin shpallen fajtorë për Vepër Penale – Vjedhje në tentativë dhe bashkëkryerje dhe dënohen me nga 100 € dhe shpenzimet Gjyqësore.
- Me date 02.04.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim për lëndën C. nr. 793/06, datë 25.03.2014, me të cilin obligohet Debitori që Kompanisë sonë t'ia paguaj shumën e të hollave në vlerë prej 376.02 €, si dhe 25 € në emër të shpenzimeve procedurale në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

- Me datë 17.04.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim me të cilin përfundon procedura përmbare e caktuar me Aktvendimin për përmbare të kësaj Gjykate E. nr. 874/07, të datës 21.02.2007, kundër Debitorit pasi që i njëjti e ka përmbushur detyrimin në tërësi.
- Me datë 18.04.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim me të cilin Aprovohet propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme të kreditorit të përmbaremit në lëndën përmbare E. nr. 684/2007 të datës 12.03.2014, dhe lihet jashtë fuqie ky Aktvendim ndaj Debitorit.
- Me datë 28.04.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim me të cilin Konstatohet se Revizioni i Paditësit është tërhequr.
- Me date 16.05.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktgjykim për lëndën C. nr. 710/05, datë 25.04.2014, me të cilin obligohet Debitori që Kompanisë t'i paguaj shumën e të hollave për borxh në vlerë prej 239.29 €, si dhe 30 € në emër të shpenzimeve procedurale në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.
- Me datë 22.05.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim për lëndën CP. nr. 1498/2013, datë 16.05.2014, me të cilin njoftohemi se përfundon Procedura e Përmbaremit sipas këtij Aktvendimi ngase Debitori e ka përmbushur detyrimin.
- Me datë 29.05.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim për lëndën E. nr. 1500/13, datë 28.05.2014, me të cilin njoftohemi se përfundon Procedura e Përmbaremit sipas këtij Aktvendimi ngase Debitori e ka përmbushur detyrimin.
- Me datë 23.06.2014 Gjkata e Apelit të Prishtinës Aktgjykim për shkak të mosbindjes për lëndën III. C. nr. 463/13 datë 05.06.2014, me të cilin njoftohemi se aprovohet në tërësi Kërkesëpadija e Kompanisë, dhe se Detyrohet e paditura N.N.T. "Çlirimi", me seli në F. Korishë, Prizren që në emër të dëmit të shkaktuar ti paguaj Kompanisë shumën e përgjithshme prej 401,59 Euro me kamat ligjore 3.5% nga data e parashtrimit të Padiisë me datë 02.04.2010, deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh.
- Me datë 02.07.2014, Gjkata e Apelit në Prishtinë Aktgjykim, GZ.br. 1996/2013, datë 04.02.2014, (lidhur me Aktgjykimin e Gj.Th. Të Prizrenit me C,nr. 173/04, datë 28.02.2013) sipas të cilit refuzohet Ankesa e Debitorit lidhur me borxhin ndaj Kompanisë, dhe Vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren.
- Me date 02.07.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim, C, nr. 281/14, datë 30.06.2014 sipas të cilit hudhet poshtë Padija (Për vërtetim të borxhit) e Paditësit si e palejuar.
- Me datë 22.09.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim, C. nr. 803/14, datë 20.08.2014, sipas të cilit refuzohet si i pabazuar Propozimi për Përmbaremi i Kreditorit të Përmbaremit ndaj kompanisë.
- Me datë 23.09.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim, P. nr. 115/14, datë 22.09.2014, sipas të cilit caktohet përfaqësuesi i përkohshëm biri i Debitorit tanimë i ndjerë.
- Me datë 14.10.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim, P. nr. 115/14, datë 10.10.2014, sipas të cilit hedhet poshtë si i palejuar Prapësimi i datës 12.08.2014 kundër Urdhërit për përmbaremi P. nr. 115/2014, të datës 04.08.2014 të Përmbaremit Privat.
- Me datë 22.10.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktgjykim, C. nr. 889/11, date 26.09.2014, sipas të cilit aprovohet në tërësi Kërkesëpadija e Paditësit K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh. A., në Prizren, dhe obligohet Debitori që Kompanisë në emër të borxhit për shpenzimet e ujit t'ia paguaj shumën prej 624.63 Euro.
- Me datë 22.10.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktgjykim, C. nr. 611/13, date 26.11.2013, sipas të cilit refuzohet në tërësi Kërkesëpadija e Paditësit dhe njëkohësisht obligohet Paditësi që të Paditurës t'ia paguaj shumën prej 20 Euro në emër të shpenzimeve Gjyqësore për Përgjigje në Padi.
- Me datë 30.10.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktgjykim, C. nr. 301/13, datë 29.09.2013, sipas të cilit refuzohet në tërësi Padija e Paditësit për kthim në vendin e punës.
- Me datë 24.11.2014, Gjkata Themelore në Prizren Aktvendim, me të cilin Refuzohet si e pabazuar kërkesa e Debitorit lidhur me Kundërshtimin e të njëjtit ndaj Përmbaremit të Përmbaremit Privat për borxhin ndaj kompanisë.

- Me datë 23.11.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim, me të cilin hudhet poshtë Padia e Padiësit për shkak të shlyerjes së borxhit në lartësi prej 1.077.⁰⁰ Euro si e (parakohshme) e palejuar nga shkak se nuk është respektuar Procedura ngaqë Padiësi ende pa bërë Ankesë në ZRRUK në Prishtinë i është drejtuar kësaj Gjykate.
- Me datë 26.12.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim për Lëndën C. nr. 1203/12, datë 17.12.2014, me të cilën lëshohet Urdhërpagesa për Padiësin K. R. U. "Hidroregjioni Jugorë" Sh. A. në Prizren, me çka Detyrohet Debitori t'i paguaj Kompanisë sonë borxhin prej 1492.06 Euro.
- Me datë 26.12.2014, Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim për Lëndën C. nr. 103/12, datë 17.12.2014, me të cilën lëshohet Urdhërpagesa për Padiësin K. R. U. "Hidroregjioni Jugorë" Sh. A. në Prizren, me çka detyrohet Debitori t'ia paguaj Padiësit borxhin prej 293.11 Euro.

LËNDË TË ARDHURA NGA PROKURORIA

- **Prokuroria** Themelore në Prizren **Njoftim** me të cilin njoftohemi se është hedhur poshtë Kallëzimi Penal në lëndën Penale HP. nr. 300/2013, datë 11.04.2014 sipas Parashkrimit dhe pamundësisë për tu vërtetuar dyshimi se është kryer vepra penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë.

KUNDËRSHTIMET NGA KONSUMATORËT DEBITOR

- Kundërshtim nga Debitori të parashtruar kundër Propozimit për Lejimin e Ekzekutimit E. nr. 642/05, për borxhin në lartësi prej 580.47 € nën arsyetimin e parashkrimit të borxhit.
- Kundërshtim nga familjari i Debitorit lidhur me lëndën EKZ. nr. 675/05, datë 05.09.2005, ku i njëjti thirret në vdekjen e prindit si dhe në vjetërsimin e kërkesës për realizimin e borxhit.
- Aktvendim për lëndën C. nr. 642/2005, datë 05.09.2005, me të cilin refuzohet Kundërshtimi I Debitorit kundër Aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit të kësaj Gjykate.
- Kundërshtim për lëndën E. nr. 682/07, sipas të cilit Debitori e kundërshton Aktvendim-in e Gjykatës Themelore në Prizren E. Nr. 682/07, sipas të cilit aprovohet Propozimi për ekzekutim të borxhit në shumën prej 545.17 Euro i Kompanisë, ku i njëjti thirret në Kontratën mbi shfrytëzimin e lokalit me qira.
- Kundërshtim për lëndën Ekz. nr. 1494/13, me të cilin njoftohemi se Debitori ka parashtruar kundërshtim ndaj kërkesës së Kompanisë për pagesën e borxhit.

VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË

- Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim lidhur me lëndën C. nr. 75/2009, datë 21.01.2014, me të cilin konsiderohet e tërhequr Padia e Padiësit K. R. U. "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. nga Prizreni për shkak të përjashtimit nga ekzekutimi, ku edhe Gjykata Supreme e Kosovës e ka Hedhë poshtë Revizionin e Kompanisë.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim lidhur me lëndën P. nr. 329/13, datë 10.02.2014, me të cilin I Akuzuari nga Kompania jonë dhe Prokurori i Shtetit, lirohet nga akuza.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim lidhur me lëndën C. nr. 3691/13, me të cilin Pranohet Ankesa e Kreditorit dhe priset Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren E. nr. 1515/13, të datës 02.10.2013, dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë në rivendosje lidhur me Lëndën për kontest pune.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim për lëndën C. nr. 399/06, sipas të cilit Padia e Kompanisë sonë ndaj Konsumatorit hedhet poshtë si e palejuar.

- Gjykata e Themelore në Prizren Aktvendim, Cp. nr. 1494/13, datë 02.09.2013, sipas të cilit kërkohet nga Kompania që në këtë Gjykatë të dërgohet Precizim i Propozimit për Ekzekutim, nën kërcënimin se mos-përbushja e kërkesës sipas këtij Aktvendimi atëherë kjo Gjykatë do të marrë vendim me të cilin do ta hedh poshtë si jo të plotë Propozimin për ekzekutim.
- Gjykata e Themelore në Prizren Aktgjykim, P. nr. 116/03, datë 08.05.2013, sipas të cilit kërkohet nga Kompania që ta kompensojmë në mënyrë solidare me Ekoregjonin Kreditorin lidhur me Shkëputjen e Kontratës mbi ndërtimin e lokalit afarist.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim Plotësues, E. nr. 1195/12, datë 29.08.2014, sipas të cilit Caktohen Shpenzimet e Procedurës së Përmbartimit në shumën prej 500 E ndaj Kreditorit të përmbartimit lidhur me kompensimin për Kontest Pune.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim, PAKR. nr. 195/14, datë 24.06.2014, sipas të cilit Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda (DKR) në Prizren, P. nr. 329/2013, datë 10.02.2014 në rastin Gëzim Doda.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim C. nr. 584/12, datë 10.11.2014, me të cilin refuzohet si e pabazuar kërkesëpadi e K.R.U. “Hidroregjioni Jugorë” Sh.A. në Prizren, me të cilën Padi është kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të dëmit të shkaktuar t`ia kompensoj shumën prej 140.744.00 Euro.

KËRKESA NGA GJYKATA THEMELORE

- Gjykata Themelore në Prizren Vërejtje për pagesë të taksave për 5 lëndë
- Gjykata Themelore në Prizren **Kërkesë**, me të cilën nga Kompania kërkohet që kësaj Gjykate - zyrës së Ekzekutimit Nr.2,ti parashtrohet Numri Personal dhe Numri i Biznesit ose edhe emrin e pronarit të Debitorit Pishina “Aqua Fantazi” në Rr. Jeta e re, pn. në Prizren.
- Gjykata Themelore në Prizren Kërkesat për Propozom për caktimin e Përfaqësuesit të përkohshëm, pasi që nga Dorëzuesit e Gjykatës është konstatuar se këta Debitorë kanë vdekur. Kërkesa ka të bëjë për tetë lëndë dhe Debitorë

PËRGJIGJE NË KËRKESAT E ARDHURA NGA GJYKATAT

- Është bërë Pagesën e taksave sipas Kërkesës së Zyrës për Ekzekutime të Gjykatës Themelore në Prizren.
- Është dorëzuar njoftimi mbi të dhënat e Debitorit si pronar i pishinës Akua Fantazi (është paditur në vitin 2005 pa emër të pronarit) shuma e borxhit 1.726.60 Euro, Padi e vitit 2005.

KUNDËRSHTIME DHE PRAPSIME NGA KONSUMATORËT DEBITORË

- Gjykata Themelore në Prizren Kundërshtim nga Debitori për lëndën C. nr. 303/2014, datë 23.09.2014.
- Është marrë tek Përmbartuesi Privat në Prizren Prapësim i parashtuar nga Debitori kundër Urdhërit për përmbartim P. nr. 300/2014, të datës 23.09.2014.
- Debitori Kundërshtim ndaj Aktvendimit E nr. 98/14, date 11.02.2014 të Gjykatës Themelore të Gjakovës Dega në Malishevë, lidhur me borxhin në lartësi prej 907.54 Euro të cilin e ka Debitori në fjalë.

PËRGJIGJE NË KUNDËRSHTIME DHE PRAPËSIME TË KONSUMATORËVE DEBITORË

- Përgjigje në Kundërshtim lidhur me lëndën C. nr. 303/2014, datë 023.09.2014. të parashtuar Debitori **për borxhin në lartësi prej 331.20 Euro.**
- Përgjigje në Prapësim lidhur me lëndën C. nr. 300/2014, datë 23.09.2014. të parashtuar nga Debitori.

- Është dërguar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, Përgjigje në Kundërshtim të cilin e ka parashtruar Konsumatori Debitorë.

**PROPOZIME PËR PËRMBARIM PËRMES PËRMBARUESVE PRIVAT KUNDËR KONSUMATORËVE DEBITORË
NDAJ KOMPANISË**

1.	22.12.2014	Posta e kosovës filiala 2 Malishevë- propozim për ekzekutim	shuma e borxhit 1.221.95
2.	22.12.2014	Posta e Kosovës, Malishevë – propozim per permbarim	Shuma e borxhit 639.32 euro
3.	22.12.2014	Raifaissen Bank– propozim per permbarim	Shuma e borxhit 1.951.68 euro
4.	26.12.2014	Shpejtim Ndrecaj Valal– shiroke Suharekë	Shuma e borxhit 835.18 euro
5.	26.12.2014	Qamil Elshani –lokal- Suharekë	Shuma e borxhit 2.454.53
6.	26.12.0214	Bashkim Sopaj – Fati tours lokal Suharekë	Shuma e borxhit 1.955.36
7.	26.12.2014	Osman Krasniqi (lokal) Suharekë	Shuma e borxhit 1.792.07
8.	26.12.2014	Spitali “Daut Mustafa” – Prizren	Shuma e borxhit 40.263.12 euro
9.	31.12.2014	Lirim Selimi –dyqan tregtie Dragash	Shuma e borxhit 1.684.04 euro.
10.	31.12.2014	Omer Rrahmani lokla Dragash	Shuma e borxhit 1.077.99 euro
11.	31.12.2014	N.J.P Magjstralja. Prizren	Shuma e borxhit 13.245.85 euro
12.	31.12.2014	Sefedin Hasani depo ndërtimore “INBIRO”rr Tirana Prizren	Shuma e borxhit 1.102.93 euro
13.	31.12.2014	Bedri Selmani Kosova Petrol Rr DE rada n r33 Prizren	Shuma e borxhit 2.833.38 euro
14.	31.12.2014	Bedri Selmani Kosova Petrol rr UCK prizren	Shuma e borxhit 1.695.32 euro
15.	31.12.2014	Bedri Selmani Kosova Petrol rr De rada nr 33 Prizren	Shuma e borxhit 2.811.48 euro.
16.	31.12.2014	Bedri Selmani Kosova Petrol r Rrasat e Koshares nr 33,Prizren	Shuma e borxhit 1.160.61 euro
17.	31.12.2014	Besim Zymberi -Dragash -lokal	Shuma e borxhit 897.07 euro
18.	31.12.2014	Agim Sadiku (firme ndertimore) Dragash	Shuma e borxhit 1.717.57 euro
19.	31.12.2014	Euro Drini Rr Prizrenit Dragash	Shuma e borxhit 1.323.25 euro

MARRËVESHJET E LIDHURA MES KONSUMATORËVE DEBITORË DHE KOMPANISË

- Marrëveshje për pagesën e borxhit me këste për lëndën P. nr. 303/2014 të konsumatorit debitorë tanimë i ndjerë të cilin e ka përfaqësuar i biri i tij për shumën e borxhit në lartësi prej **1.033.33 Euro**.
- Marrëveshje për pagesën e borxhit me këste për lëndën P. nr. 297/2014 të konsumatorit debitorë.

URDHËR PËR PËRMBARIM NGA PËRMBARUESIT PRIVAT KUNDËR KOMPANISË

- Me datë 19.12.2014, është sjellë Lënda P. nr. 916/14 (Urdhër për Përmbarim), datë 17.12.2014, nga Përmbaruesi Privat në Gjakovë ku Kompania është Debitorë.
- Me datë 19.12.2014, është sjellë Lënda P. nr. 729/2014 (Urdhër për Përmbarim), datë 16.12.2014, nga Përmbaruesi Privat ku Kompania është Debitorë.

PARASHTRESË PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESIT TË PËRKOHSHËM

- Përmbaruesi Privat, Parashtresë për Caktimin e Përfaqësuesit të Përkohshëm për lëndën C. nr. 300/2014, datë 23.09.2014, pasi që Debitori ka vdekur, ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Parashtresë për Caktimin e Përfaqësuesit të Përkohshëm për lëndën C. nr. 510/05, pasi që Debitori ka vdekur, ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr 224/05 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr . 675/05 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr 544/05 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr 1352/06 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr. 505/05 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr. 346/06 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën E. nr. 663/05 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.
- Kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për lëndën Cp. nr 483/14 pasi që Debitori ka vdekur ndërsa Propozimi ynë konsiston në caktimin e ndonjërit prej familjarëve të Debitorit të ndjerë si Përfaqësues të përkohshëm.

KALLËZIME PENALE NË PROKURORINË THEMELORE NË PRIZREN

- Kallëzim penal për konsumatorin i cili pas shkyqjes nga ana e Kontrollës është rikyqur në rrjetin e ujësjellësit.
- Kallëzim Penal ndaj konsumatorit ngase ekipi i Kontrollës së Kompanisë gjatë kontrollës së bërë në pasurinë e të njëjtit ka hasur në kyqje ilegale në rrjetin e ujësjellësit të Kompanisë.
- Kallëzim penal për konsumatorin i cili pas shkyqjes nga ana e Kontrollës është rikyqur në rrjetin e ujësjellësit.

- Kallëzim penal për konsumatorin i cili pas shkyqjes nga ana e Kontrollës është rikyqur në rrjetin e ujësjellësit.

KONKLuzion

- Nga Gjykata Themelore në Prizren 16 (Gjashtëmbëdhjetë) KONKLuzIONE (E. nr. 511/05, E. nr. 556/05, E. nr. 514/05, E. nr. 646/05, E. nr. 224/05, E. nr. 544/05, E. nr. 681/05, E. nr. 645/05, E. nr. 310/06, E. nr. 328/06, E. nr. 1355/06, E. nr. 330/06, E. nr. 333/06, E. nr. 695/07, E. nr. 674/07, E. nr. 655/07), me të cilat është kërkuar që në afat prej 3 (tri) ditësh kësaj Gjykate ti ofrohen të dhëna shtesë lidhur me Adresat e sakta të konsumatorëve nën kërcënimin e hedhjes poshtë të Propozimeve për ekzekutim.
- Për 15 (pesëmbëdhjetë) Konkluzione i është dhënë përgjigje kësaj Gjykatë ndërsa për 1 (një) Konkluzion nuk ka pasur informatë shtesë lidhur me vendndodhjen e konsumatorit.
- Nga Gjykata e Themelore në Prizren Konkluzion, E,nr. 142/2006, datë 04.07.2014, sipas të cilit shtyhet procedura përbarimore sipas njoftimit të bërë nga Kreditori i përbarimit, ndaj Debitorit të kësaj lënde pasi që me të njëjtin është arritur marrëveshje për pagesën e borxhit me këste.
- Nga Gjykata e Themelore në Prizren Konkluzion , E. nr. 671/2007, datë 04.07.2014, sipas të cilit shtyhet procedura përbarimore sipas njoftimit të bërë nga Kreditori i përbarimit, ndaj Debitorit pasi që është arritur marrëveshja për pagesën e borxhit me këste.
- Nga Gjykata e Themelore në Prizren Konkluzion , E,nr. 1355/2006, datë 04.07.2014, sipas të cilit shtyhet procedura përbarimore sipas njoftimit të bërë nga Kreditori i përbarimit, ndaj Debitorit pasi që është arritur marrëveshja për pagesën e borxhit me këste.
- Për Lëndën E. nr. 681/2005 Gjykata Themelore në Prizren Konkluzion, me të cilën Pezullohet Procedura përbarimore për 6 muaj për shkak se adresa e Debitorit të përbarimit është e pasaktë. Kjo procedurë mundë të vazhdojë nënë afatin prej 6 muajve nëse Kompania sjellë adresën e saktë të Debitorit, në të kundërtën kjo çështje konsiderohet e përfunduar.
- Konkluzion nga Përbaruesi Privat i Gjakovës me të cilin Njoftohemi se Propozim Marrëveshja e datës 24.12.2014 është pranuar nga Kreditori - Kompania Regjionale e Ujitjes “ Radoniqi-Dukagjini” nga Gjakova ashtu siç edhe e kemi bërë Propozim Marrëveshjen.

NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE

- **Aktvendim lidhur me lëndën C. nr. 319/06**, me të cilin ndërpritet çështja juridike kontestimore **për shkak të vdekjes së të Paditurit për borxh.**
- Gjykata e Themelore në Prizren Aktvendim, C. nr. 1071/12, datë 30.06.2014, sipas të cilit ndërpritet procedura juridike kontestimore ndaj Debitorit për shkak të vdekjes së debitorit.
- Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim, C. nr. 391/12, datë 31.07.2014, sipas të cilit ndërpritet Procedura në këtë çështje Juridike - kontestimore për shkak të vdekjes së të Paditurit.
- Gjykata Themelore e Prizrenit ka ardhur Lënda C. nr. 510/05 me të cilën njoftim njoftohemi se Debitori

LËNDËT TË CILAT GJINDEN NË PROCEDURË DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr	Emri, mbiemri dhe Adresa	C. nr	Kontesti	Vlera	Vërejtje
01	Remzi Hoxha nga Zhuri, KK Prizren	C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013	Padi - Kthim në vendin e punës	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
02	Hanefi Muharremi, nga Prizreni	C. nr. 214/10	Padi – Kthim në vendin e punës	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës
03	Ilijaz Buleci nga Prizreni, dhe 2 (dy) ndërgjygjës	C. nr. 603/09, Datë 29.07.2013	Padi – Kompensim i të ardhurave personale	Dëmshpërblim- 15.450.55 E	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
04	Xhezair Bajrami, KK. Dragash,	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për Dëmshpërblim	Dëmshpërblim në vlerë prej 25.753.52 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
05	ENVER VILA, Rr. Suzi Qelebi, nr. 72 në Prizren	C. nr. 1078/13, datë 17.04.2014	Padi për DËMSHPËRBLIM	DËMSHPËRBLIM në vlerë prej 24.000,00 €	Kjo lëndë gjendet ende në proces të Gjykatës Themelore të Prizrenit
06	Gëzim Doda nga Prizreni	C. nr. 301/13, datë 29.09.2014	Padi –Kontest pune	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit

- C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013, Padi për kthim në vendin e punës, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
- C. nr. 214/10, Padi për kthim në vendin e punës, dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Dhomën e veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë.
- C. nr. 603/09, datë 29.07.2013, Padi – Kompensim i të ardhurave personale, Dëmshpërblim- **15.450.55 E**, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
- C. nr. 116/03, datë 08.05.2013, Padi për dëmshpërblim, dëmshpërblimi i kërkuar është në vlerë prej **25.753.52 Euro**, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
- 5. C. nr. 1078/13, datë 17.04.2014, Padi për dëmshpërblim, në vlerë prej **24.000,00 €**, Kjo lëndë gjendet ende në proces të Gjykatës Themelore të Prizrenit.
- C. nr. 301/13, datë 29.09.2014, Padi –Kontest nga marrëdhënia e punës, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Masat e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2014

Tremujori i IV-të	Masa e qortimit	Hidhet poshtë	Masa e pezullimit	Masa e dënimit në Euro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënimeve në E
Janar	/	/	/	16	16	1510. ⁰⁰ €
Shkurt	/	/	/	/	/	/
Mars	/	2	1	/	3	/
Prill	/	/	/	/	/	/
Maj	/	/	/	/	/	/
Qershor	/	/	/	/	/	/
Korrik	2	1	2	/	5	/
Gusht	/	/	/	/	/	/
Shtator	/	/	/	/	/	/
Tetor	/	/	/	100 Euro	1	100 Euro
Nëntor	/	/	/	/	/	/
Dhjetor	/	/	/	100 Euro	1	100 Euro
Totali	2	3	3	16	24	1710.⁰⁰ €

Paraqitja tabelore e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve për Vitin 2014

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Janar	46	
Shkurt	28	
Mars	58	
Prill	30	
Maj	37	
Qershor	31	
Korrik	18	
Gusht	44	
Shtator	31	
Tetor	40	
Nëntor	42	
Dhjetor	25	
Totali	430	

Gjatë këtij viti janë shqyrtuar edhe Ankesat e konsumatorëve të cilat në total janë 430 (katërqindtë e tridhjetë) Ankesa.

Ankesat e konsumatorëve janë shqyrtuar në aftin optimal nga Komisioni për shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve ku janë nxjerrë Vendime dhe të njëjtat u janë dërguar konsumatorëve.

2.3.6 RAPORT I ZYRES SË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezentohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

Raporti i IT

Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

Nderhyrje në njësinë e Malishevës, Suharekë, Dragash dhe Prizren (print, server, vpn router, klient, aparate të fotokopjes etj)

Ueb faqe: 16 dokumente të publikuara Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit. Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësi, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave. Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks. Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë

Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani. Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike. Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Është ndertuar ueb faqen e kompanisë Hidroregjioni Jugor. Është porositur një server IBM të ri. Janë vendosur 4 kamera në njësinë Malisheve Janë shtuar role të reja në Servere (DNS 2, DHCP). Është krijuar arka dhe përdorues të rinjë, në përputhje me kërkesat e kompanisë. Përditësimi i ueb faqës së Kompanisë. Është marrë Serveri e ri të dedikuar për Databazë. Zhvillim i trajnimeve praktike dyjavore me studentë Universitetit të Prizrenit. Konfigurim i virtual serverëve në përputhje me kërkesat e Kompanisë. Përkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve. Konfigurim i virtual serverëve në përputhje me kërkesat e Kompanisë. Konfigurim i serverit të ri të databazës; IBM x3630 m4 me 24 cpu (logjik), 2 fizik dhe 24GB RAM. Krijimi i serverit antivirus, Symantec Endpoint Protection, për shpërndarje të antiviruseve në klientet (kompjuteret) e Kompanisë. Krijimi i serverit ësus për përditësimet e kompjuterëve nga serveret e microsoft. Krijimi i backup serveret e njësi, në rast demtimi, humbje e shënimeve, serveret tjerë mbajnë kopje të serverëve kryesore. Furnizimi me një fotokopje të re, Xerox ëorkcentre 3545, për printimin e faturave dhe ka funksionur shumë mirë. Furnizimi me 5 kompjutere të rinjë, lenovo 2.9Ghz Cpu, 2GB RAM, 19" Samsung monitor. Një është në baze tek zyra e logjistikes, një tek Filtrat, dy në njësinë e Therandës, dhe një në Shatërvan. Është krijuar arkë e re dhe përdorues në Komunën e Prizrenit Është vendosur rrjeti i ipkos në arkën e re të Komuna e Prizrenit (up to 5 mbps doëload, up to 5 mbps upload) Kemi marrë fotokopjen e re Xerox Workcentre 5645 për shtypjen e faturave Kemi bërë servisimin e dy fotokopjeve. Ate kryesore dhe të inkasanteve.

Konkluzion

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të vitit 2014. Janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si dhe statutin e Kompanisë. Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë. Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregullorëve të nevojshme për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimëve të dalura nga Menaxhmenti, Bordi i Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

2.3.7 RAPORT I ZYRTARIT PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË

Është punuar në përgatitjen e Rregullores për mbrojtjen nga zjarri;
 Zyra për Siguri në punë së bashku me Zyrën Ligjore ka marrë pjesë aktive në nxjerrjen e Rregulloreve tjera të Kompanisë;
 Janë përpiluar Kontrata dhe Marrëveshje të ndryshme;
 Janë përpiluar shkresa të ndryshme për institucione dhe individ të ndryshëm;
 Janë kryer përkthime të Konkurseve dhe shkresave tjera nga gjuha Shqipe në gjuhën Boshnjake dhe anasjelltas;
 Janë analizuar Ligje, Rregullore, Udhëzime administrative dhe materiale tjera me interes për mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve në punë;
 Kemi pasur kontakte zyrtare me njësinë e Zjarrfikësve dhe organet Komunale lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë në punë;
 Janë vizituar të gjitha objektet e Njesisë Punuese të Prizrenit lidhur me nevojat për servisim dhe plotësim të vendeve me aparate kundër zjarrit, me ç`rast i kemi bërë me shkrim nevojat e Kompanisë për servisimin dhe blerjen e aparateve të reja për mbrojtje nga zjarri;
 Janë kontaktuar edhe kompaninë e cila merret me servisimin dhe shitjen e aparateve kundër zjarrit ku jemi njoftuar edhe çmimet e serviseve dhe çmimet e shitjes së aparateve të rinj kundër zjarrit me çka në formë të shkruar dhe kemi bërë njoftim në Kompani;
 Janë finalizuar instruksionet për Rreziqet dhe se si duhet vepruar për mbrojtje nga energjia elektrike në objekte dhe instruksionet për punëtorët të cilët punojnë me klorinatorë gazi;
 Është bashkëpunuar ngushtë me Zyrën ligjore për të gjitha punët e lartcekura, ku bashkëpunimi ka qenë i ndërsjellë dhe me interes për Kompaninë.
 Është përfunduar puna rreth Rregullores për mbrojtjen nga zjarri, mirëpo duhet të pritet finalizimi dhe aprovimi i Rregullores së Re të Qeverisë të harmonizuar me Ligjin e Ri ku duhet të bëhet harmonizimi me Rregulloren e Re;
 Është komunikuar me shkresa dhe kontakte fizike me institucione të ndryshme, me Njësinë e Zjarrfikësve, Kuvendin Komunal etj. ;
 Janë kryer vizita nëpër disa nga objektet të cilat janë me prioritet lidhur me punët që duhet kryer nëpër këto objekte;
 Sipas nevojës e kemi përfaqësuar Kompaninë në Gjykatë;
 Janë kryer edhe punë tjera nga fushë-veprimtaria e zyrës për siguri në punë;

2.4.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI FINANCIAR

KOMENTET FINANCIARE

Aktivitetet

Gjatë vitit 2014, shërbimi financiar ka pasur aktivitete të shumta, në arritjen e përfomancave të kompanisë. Më poshtë do t'i cekim ndër më kryesoret:

- Raportet e rregullta ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, regjistrimi i tyre.
- Gjithashtu, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, ku shikohet se a janë të nevojshme blerjet, janë apo jo me kontratë, etj.

- Pregatitja e raporteve mujore-tremujore-gjashtëmujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj,
- Takimet e rregullta, në lidhje me performancën e kompanisë, si me menaxhmentin e kompanisë si dhe anëtarët e bordit.
- Raportimet tre mujore dhe vjetore në MZHE për subvencionet e ndara, për investimet kapitale që kemi bërë të bëra nga mjetet e tyre.
- Të gjitha investimet, si ato nga subvencionet dhe ato vetanake, është bërë regjistrimi i investimeve në mënyrë të vazhdueshme, nga zyrtari i regjistrimit të aseteve.
- Githashtu edhe në këtë fund vit, sipas detyrimeve ligjore, janë caktuar komisionet për regjistrimin dhe barazimin e arkave, inventarit dhe stokeve në depo.
- Kemi pasur angazhime të shumta për një inkasim sa më të mirë, ku në këtë vit inkasimi si përqindje, në raport me vitin 2013, është më i lartë.

Arsyeshmeria e shpenzimeve

- Shpenzimet operative të ndërmarrjes, kanë qenë më të larta në 2014, në krahasim me shpenzimet e vitit të kaluar. Kjo do të thotë se aktivitetet e ndërmarrjes kanë qenë më të medha, në mirëmbajtje, në angazhim të punëtorëve etj.
- Nëse i shikojmë disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve ku mund të kenë pasur rritje apo zvoglim të shpenzimeve, atëherë te pozicioni i pagave kemi një rritje, në krahasim me vitin e kaluar. Më lartë e cekëm, që kompania ka shtuar aktivitetin e saj, dhe me këtë ka qenë e nevojshme edhe shtimi i stafit të saj, në mënyrë që shërbimet tona t'i kënaqin nevojat e konsumatorëve, si atyre aktual dhe konsumatorëve potencial.
- Pozicioni tjetër i cili ka ndikuar në rritje të shpenzimeve operative, është ai i energjisë elektrike. Edhe viti 2014 ka qenë vit I investimeve, ku kemi bërë investime në gjetjen e burimeve të reja dhe kjo direkt ka ndikuar edhe në shtimin e pompave, dhe me këtë rast kemi edhe shpenzim më të madh të energjisë elektrike. Pra gjendja me furnizim me ujë është shumë më e mirë në krahasim me vitet e kaluara.
- Te shpenzimet e derivative kemi nuk kemi ndonjë ndryshim të madh, por që ka pak levizje nga njësia në njësi.
- Edhe te mirëmbajtja dhe riparimet kemi rritje të shpenzimeve. Te gjitha arsyet e cekura më lartë, kanë dikuar edhe tek ky pozicion. Nevoja në mirëmbajtje të rrjetit, atij aktual si dhe rrjetit të ri.

Njësia Suharekë

- Shpenzimet gjatë vitit 2014 kanë qenë relativisht të njëjta nëpër tre mujorë me përjashtim të TM1 ku kemi pasur shpenzime pak më të mëdha dhe atë si pasojë e angazhimit të vazhdueshëm të njësisë operative, gjatë ndërtimit të Rezervuarit të ri të ujit të "Krismat" në Baçevc.
- Energjia elektrike është një nga pozicionet që shkakton shpenzime të konsiderueshme si pasojë e angazhimit të pompave në stacionet e ndryshme të pompimit dhe instalimit të disa pompave të reja në Bqçevc.
- Derivatet e naftës poashtu janë shpenzimet për shkak të aktiviteteve të përditshme të Operativës si dhe për shkak të angazhimit të vazhdueshëm në projekte të caktuara në zgjerimin e rrjetit e sidomos në gjysmën e parë të vitit jemi angazhuar në projektin për Rezervuarin e ri në Baçevc.

- Puna jashtë orarit në këtë vit është një nga pozicionet që ka shkaktuar shpenzime si pasojë e angazhimit në projektin e Rezervuarit dhe të galerisë në Baçevc.
- Materiali shpenzues i administrates është përafërsisht në të njëjtin nivel.
- Mirëmbajtja dhe riparimi, kemi ngritje të dukshme të shpenzimeve.(tetor 2.448,85 që duhet rishikuar dhe kam kërkuar edhe në takim të menxhmentit).
- Mirëmbajtja e automjeteve është poashtu një nga pozicionet që vazhdimisht krijon shpenzime për shkak të amortizimit të skajshëm të automjeteve.

Njësia Dragash

- Shpenzimet: Janë më të larta për 14.15% në krahasim me vitin 2013.Këto shpenzime janë krijuar në
- riparimin e rrjetit të ujësjellsit dhe në zgjerimin e rrjetit në lagje të ndryshme periferike të vendbanimeve
- dhe pjesa tjetër në të ardhura personale si dhe shpenzimet nga marrja në menaxhim të fshatit Brezne ku
- furnizimi bëhet me pompim që i ka rritë shpenzimet operative.
- Rryma elektrike 6.226.91 euro,
- Shpenzimet e derivateve 1.782.57 euro,
- Mirëmbajtja dhe riparimet 6.509.34 euro,
- Mirëmbajtja e automjeteve 2.759.22 euro,
- Kemikaljet 248.28 euro dhe
- Shpenzime tjera në shumën prej 2.525.71 euro.
- Të gjitha këto shpenzime në vitin 2014.janë të mbulushme nga të hyrat që i ka krijuar Njësia Operative në Dragash.

Njesia Malishevë

- Paga bruto /€ -2013,kanë qenë 121.133.21€ , ndërsa në vitin 2014 ato janë 133.315.65€ pra janë rritur për 12.182.44€ ose 10.05%, shpenzimet ne paga jane rritur pershkak te rritjes se numrit te punetoreve ne Njesine e Malisheves edhe per 5 punëtorë te rinje,por edhe te angazhimeve te punetoreve te operatives ne realizimin e projekteve investive mbas orarit te rregullt te punes dhe te shtuneve e te dieleve.
- Energjia elektrike/€ Ne vitin 2013 jane shpenzu 96.738.95 € ,kurse ne vitin 2014 jane shpenzu 97.687.40€ ,ose vetem 948 € me shume se ne vitin paraprak, dhe kjo rritje eshte bere ngase eshte marre ne menaxhim nga muaji prill/2014 edhe ujesjellesi ne fshatin shkozë,
- Shpenzimet ne derivate /€ ne vitin 2013 jane shpenzu 8.346.70 € ,ndersa ne vitin 2014 jane shpenzu 11.157.71 € ose 2.811.01€ me shume ,ose 33.67% me shume se ne vitin paraprak.Rritja kaq e madhe e shpenzimeve te derivateve ne vitin 2014 ka ndodhe pasi kete vit kemi pasur marreveshje per sherbime me KK te Malisheves per mirembajtjen e gropave septike neper shkollat fillore dhe te mesme ,si dhe mirembajtjen e kanalizimeve te ujerave te zeza neper fshatrat qe ne ende nuk i menaxhojme, nga te cilat sherbime kemi realizu edhe te hyra te konsiderueshme per Njesine tone.
- Shpenzimet ne Mirembajtje operative gjate vitit 2013 kane qene 20.279.98€ ,ndersa gjate vitit 2014 ato kane qene 15.306.75 € ose per 4.973.23 € me pak se vitin paraprak.Keto shpenzime jane ulur pasi vitin e kaluar ne keto shpenzime jane llogaritur edhe disa shpenzime qe i kemi realizu si investime si psh . ne Senik, gjate hapjes se puseve dhe hapjen e rrugeve ,evitimin e defekteve ne rrjetet e banoreve te senikut dhe disa shpenzime tjera .
- Shpenzimet tjera operative per nevoja te Njesisë jane rritur 2.854.82 €, ne vitin 2014 krahasuar me shpenzimet e vitit 2013 si ne klor ,rroba pune (veshmbathje), por edhe defekte te automjeteve.

- Angazhimi nuk do të ndalet, në arritjen e performancave sa më të mira, duke rritur edhe më tutje investimet, në zvogëlimin e shpenzimeve operative aty ku është e mundshme, duke u angazhuar në rritje të inkasimit, ku nga vitit në vit edhe inkasimi ka shënuar rritje dhe kjo direkt ndikon në përfomancat e kompanisë.

**2.4.1.1 PASQYRË TË PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE
JANAR – DHJETOR 2013- 2014**

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	JAN-DHJET-2013	JAN-DHJET-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	15,580,205	13,562,010	(2,018,195)	-12.95
Faturimi m3	6,175,221	5,557,440	(617,781)	-10.00
Faturimi nga uji €	3,298,024.73 €	3,043,521.65 €	- 254,503.08 €	-7.72
Faturimi- te tjera €	74,836.26 €	66,849.11 €	- 7,987.15 €	-10.67
Faturimi Total €	3,372,860.99 €	3,110,370.76 €	- 262,490.23 €	-7.78
Inkasimi nga uji €	2,463,511.85 €	2,385,052.62 €	- 78,459.23 €	-3.18
Inkasimi - te tjera €	64,777.98 €	48,418.86 €	- 16,359.12 €	-25.25
Inkasimi Total €	2,528,289.83 €	2,433,471.48 €	- 94,818.35 €	-3.75
Nr. i Konsumatorëve	29512	30668	1156	3.92
% e inkasimit	74.70	78.36	3.67	4.91
Shpenzimet	2,338,669.58 €	2,330,349.27 €	- 8,320.31 €	-0.36
Uji I pafaturuar në m3	9,404,984	8,004,570	(1,400,414)	-14.89
Uji I pafaturuar ne %	60.36	59.02	-1.34	-2.22
Mbulimi operativ	1.08	1.04	-0.04	-3.41
	189,620.25 €	103,122.21 €	- 86,498.04 €	

2.4.1.2 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

MUAJI	JAN-DHJET-2013	JAN-DHJET-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	1,905,717	2,137,527	231,810	12.16
Faturimi m3	818,845	807,304	-11,541	-1.41
Faturimi nga uji €	443,515.71 €	438,563.52 €	- 4,952.19 €	-1.12
Faturimi- te tjera €	24,397.82 €	15,549.20 €	- 8,848.62 €	-36.27
Faturimi Total €	467,913.53 €	454,112.72 €	- 13,800.81 €	-2.95
Inkasimi nga uji €	226,799.87 €	271,604.83 €	44,804.96 €	19.76
Inkasimi - te tjera €	26,741.55 €	15,206.49 €	- 11,535.06 €	-43.14
Inkasimi Total €	253,541.42 €	286,811.32 €	33,269.90 €	13.12
Nr. i Konsumatorëve	4737	5195	458	9.67
% e inkasimit	51.14	61.93	10.79	21.11
Shpenzimet	320,455.56 €	353,792.26 €	33,336.70 €	10.40
Uji I pafaturuar në m3	1,086,872	1,330,223	243,351	22.39
Uji I pafaturuar ne %	57.03	62.23	5.20	9.12
Mbulimi operativ	0.79	0.81	0.02	2.46
	- 66,914.14 €	- 66,980.94 €	- 66.80 €	

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	JAN-DHJET-2013	JAN-DHJET-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
